FLETORJA ZYRTARE
E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

www.qbz.gov.al

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2026 – Numri: 72

Tiranë – E mërkurë, 8 prill 2026

PËRMBAJTJA

		Faqe
Dekret i Presidentit nr. 173, datë 31.3.2026	Për lejimin e lënies së shtetësisë shqiptare.....	5351
Dekret i Presidentit nr. 174, datë 31.3.2026	Për lejimin e lënies së shtetësisë shqiptare.....	5351
Dekret i Presidentit nr. 175, datë 31.3.2026	Për lejimin e lënies së shtetësisë shqiptare.....	5351
Dekret i Presidentit nr. 176, datë 31.3.2026	Për lejimin e lënies së shtetësisë shqiptare.....	5351
Dekret i Presidentit nr. 177, datë 31.3.2026	Për dhënie të shtetësisë shqiptare.....	5352
Dekret i Presidentit nr. 178, datë 31.3.2026	Për dhënie të shtetësisë shqiptare.....	5352
Dekret i Presidentit nr. 179, datë 31.3.2026	Për dhënie të shtetësisë shqiptare.....	5352
Dekret i Presidentit nr. 180, datë 31.3.2026	Për dhënie të shtetësisë shqiptare.....	5353
Dekret i Presidentit nr. 181, datë 31.3.2026	Për dhënie të shtetësisë shqiptare.....	5353
Dekret i Presidentit nr. 182, datë 31.3.2026	Për dhënie të shtetësisë shqiptare.....	5353
Dekret i Presidentit nr. 183, datë 31.3.2026	Për dhënie të shtetësisë shqiptare.....	5354

Dekret i Presidentit nr. 184, datë 31.3.2026	Për dhënie të shtetësisë shqiptare.....	5354
Dekret i Presidentit nr. 185, datë 31.3.2026	Për dhënie të shtetësisë shqiptare.....	5354
Dekret i Presidentit nr. 186, datë 31.3.2026	Për dhënie të shtetësisë shqiptare.....	5354
Dekret i Presidentit nr. 187, datë 31.3.2026	Për dhënie të shtetësisë shqiptare.....	5355
Dekret i Presidentit nr. 188, datë 31.3.2026	Për dhënie të shtetësisë shqiptare.....	5355
Dekret i Presidentit nr. 189, datë 31.3.2026	Për dhënie të shtetësisë shqiptare.....	5355
Dekret i Presidentit nr. 190, datë 31.3.2026	Për dhënie të shtetësisë shqiptare.....	5356
Dekret i Presidentit nr. 191, datë 31.3.2026	Për dhënie të shtetësisë shqiptare.....	5356
Dekret i Presidentit nr. 192, datë 31.3.2026	Për dhënie të shtetësisë shqiptare.....	5356
Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 317, datë 26.3.2026	Për ndalimin e peshkimit në liqenin e Shkodrës.....	5357
Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 318, datë 26.3.2026	Për ndalimin e peshkimit në liqenet e Prespës, Fierzës, Ulzës dhe Shkopetit.....	5357
Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 321, datë 26.3.2026	Për disa shtesa dhe ndryshime në urdhrin nr. 113, datë 15.3.2022, "Për miratimin e rregullores për masat mbrojtëse kundër dëmtuesve të bimëve", i ndryshuar.....	5358
Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 340, datë 30.3.2026	Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së influencës aviare me patogjenitet të lartë të shpendëve, të shfaqur në shtetin e Italisë.....	5365
Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 345, datë 31.3.2026	Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së pseudopestit të shpendëve, të shfaqur në shtetin e Polonisë.....	5366
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 74, datë 12.3.2026	Mbi fillimin e procedurës për shqyrtimin e kërkesës së shoqërisë "Nova Solar System" sh.p.k., për modifikimin e licencës në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik me kapacitet të instaluar 50 mw.....	5368

Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 75, datë 12.3.2026	Mbi fillimin e procedurës për shqyrtimin e kërkesës së shoqërisë "EZ-5 Energy" sh.p.k. për modifikimin e licencës në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik me kapacitet të instaluar 30 mw.....	5369
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 76, datë 12.3.2026	Mbi fillimin e procedurës për shqyrtimin e kërkesës së shoqërisë "EZ-5 Energy" sh.p.k. për modifikimin e licencës në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik me kapacitet të instaluar 10 mw.....	5370
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 77, datë 12.3.2026	Mbi miratimin e disa ndryshimeve në vendimin e Bordit të ERE-s nr. 302, datë 17.11.2025, "Mbi licencimin e shoqërisë 'Spitalla Solar' sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike".....	5371
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 78, datë 12.3.2026	Mbi miratimin e kërkesës së shoqërisë "Noa Energy Trade" sh.p.k. për krijimin e llogarisë në regjistrin elektronik të garancive të origjinës	5372
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 79, datë 12.3.2026	Mbi miratimin e kërkesës së shoqërisë "Devol Hydropower" sh.a. për krijimin e llogarisë në regjistrin elektronik të garancive të origjinës dhe regjistrimin fillestar të pajisjeve të prodhimit për HEC "Moglicë" dhe HEC "Banjë"	5373
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 80, datë 12.3.2026	Mbi miratimin e kërkesës së shoqërisë "Nova Solar System" sh.p.k. për krijimin e llogarisë në regjistrin elektronik të garancive të origjinës dhe regjistrimin fillestar të pajisjeve të prodhimit për centralin fotovoltaik.....	5374
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 81, datë 12.3.2026	Mbi miratimin e disa ndryshimeve në "Rregulloren për cilësinë e furnizimit dhe performancën e sigurisë së rrjetit në sistemin e transmetimit të energjisë elektrike", miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 207, datë 18.12.2017 dhe në treguesit e kritereve standarde të cilësisë së shërbimit në sistemin e transmetimit të energjisë elektrike.....	5376
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 82, datë 19.3.2026	Mbi fillimin e procedurës për shqyrtimin e kërkesës së shoqërisë "Hydrosolar Energy (HSE)" sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike.....	5378
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 83, datë 19.3.2026	Mbi fillimin e procedurës për shqyrtimin e kërkesës së shoqërisë "Sunny Side Energy" sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike.....	5379
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 84, datë 19.3.2026	Mbi dhënien e autorizimit nga ERE për vendosjen e kuotave të shoqërisë "SA-GLE kompani" sh.p.k. si mjet për garantimin e detyrimit ndaj të tretëve.....	5381
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 85, datë 19.3.2026	Mbi miratimin e kërkesës së shoqërisë "Ener Trade" sh.p.k. për krijimin e llogarisë në regjistrin elektronik të garancive të origjinës.....	5384
Kërkesë e Agjencisë Shtetërore për Shpronësimin nr. 193/6, datë 1.4.2026	Për shpronësim, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit "Ndërtimi i Ujësjellësit Çukë–Bërbënesh", Bashkia Sarandë.....	5385

Vendim i Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë nr. 41-2025-1754 (424), datë 20.5.2025	Për heqjen e zotësisë për të vepruar të shtetasit Orjol Myftarago.....	5386
Vendim i Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë nr. 41-2025-2063 (487), datë 11.6.2025	Për heqjen e zotësisë juridike për të vepruar të shtetasit Aleko Manoku.....	5386
	Kërkesë për shpalljen të zhdukur të shtetasit Kujtim Tafaj.....	5386

DEKRET
Nr. 173, datë 31.3.2026

PËR LEJIMIN E LËNIES SË SHTETËSISË SHQIPTARE

Në mbështetje të nenit 92, shkronjës "c", nenit 93 të Kushtetutës; neneve 13, 20 e në vijim të ligjit nr. 113/2020, "Për shtetësinë", i ndryshuar, me propozim të ministrit të Punëve të Brendshme,

DEKRETOJ:

Neni 1

U lejohet lënia e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të tyre, shtetasve:
1. Brunilda Qazim Resuli
2. Senad Zija Hasani

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj

DEKRET
Nr. 174, datë 31.3.2026

PËR LEJIMIN E LËNIES SË SHTETËSISË SHQIPTARE

Në mbështetje të nenit 92, shkronjës "c", nenit 93 të Kushtetutës; neneve 13, 20 e në vijim të ligjit nr. 113/2020, "Për shtetësinë", i ndryshuar, me propozim të ministrit të Punëve të Brendshme,

DEKRETOJ:

Neni 1

U lejohet lënia e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të tyre, shtetasve:
1. Adrian Gjok Prekperaj
2. Enxhi Haki Mingla
3. Rajna Benard Zoto
4. Nikolina Zoran Goroviq

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj

DEKRET
Nr. 175, datë 31.3.2026

PËR LEJIMIN E LËNIES SË SHTETËSISË SHQIPTARE

Në mbështetje të nenit 92, shkronjës "c", nenit 93 të Kushtetutës; neneve 13, 20 e në vijim të ligjit nr. 113/2020, "Për shtetësinë", i ndryshuar, me propozim të ministrit të Punëve të Brendshme,

DEKRETOJ:

Neni 1

U lejohet lënia e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të tyre, shtetasve:
1. Kevin Luan Kamberi
2. Daniela Halil Lupoae
3. Lluko Lubo Krstović
4. Kristia Genci Çapi

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj

DEKRET
Nr. 176, datë 31.3.2026

PËR LEJIMIN E LËNIES SË SHTETËSISË SHQIPTARE

Në mbështetje të nenit 92, shkronjës "c", nenit 93 të Kushtetutës; neneve 13, 20 e në vijim të ligjit nr. 113/2020, "Për shtetësinë", i ndryshuar, me propozim të ministrit të Punëve të Brendshme,

DEKRETOJ:

Neni 1

U lejohet lënia e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të tyre, shtetasve:

1. Megi Artan Berberi
2. Selma Lulzim Iljazi
3. Mandalena Gjin Kola

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj

DEKRET
Nr. 177, datë 31.3.2026

PËR DHËNIE TË SHTETËSISË SHQIPTARE

Në mbështetje të nenit 92, shkronjës "c", nenit 93 të Kushtetutës; neneve 9, 20 e në vijim të ligjit nr. 113/2020, "Për shtetësinë", i ndryshuar, me propozim të ministrit të Punëve të Brendshme,

DEKRETOJ:

Neni 1

Dhënien e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të tij, shtetasit:

1. Omar Ali Omar Mohammad Babtain

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj

DEKRET
Nr. 178, datë 31.3.2026

PËR DHËNIE TË SHTETËSISË SHQIPTARE

Në mbështetje të nenit 92, shkronjës "c", nenit 93 të Kushtetutës; neneve 9, 20 e në vijim të ligjit nr. 113/2020, "Për shtetësinë", i ndryshuar, me propozim të ministrit të Punëve të Brendshme,

DEKRETOJ:

Neni 1

Dhënien e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të saj, shtetases:

1. Amarbir Sukhbir Singh Kaur

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj

DEKRET
Nr. 179, datë 31.3.2026

PËR DHËNIE TË SHTETËSISË SHQIPTARE

Në mbështetje të nenit 92, shkronjës "c", nenit 93 të Kushtetutës; neneve 9, 20 e në vijim të ligjit nr. 113/2020, "Për shtetësinë", i ndryshuar, me propozim të ministrit të Punëve të Brendshme,

DEKRETOJ:

Neni 1

Dhënien e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të tij, shtetasit:

1. Sarp Unal Tahsin Cem Heris

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj

DEKRET
Nr. 180, datë 31.3.2026

PËR DHËNIE TË SHTETËSISË SHQIPTARE

Në mbështetje të nenit 92, shkronjës "c", nenit 93 të Kushtetutës; neneve 9, 20 e në vijim të ligjit nr. 113/2020, "Për shtetësinë", i ndryshuar, me propozim të ministrit të Punëve të Brendshme,

DEKRETOJ:

Neni 1

Dhënien e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të saj, shtetases:
1. Hazal Rizvan Demirdöver

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj

DEKRET
Nr. 181, datë 31.3.2026

PËR DHËNIE TË SHTETËSISË SHQIPTARE

Në mbështetje të nenit 92, shkronjës "c", nenit 93 të Kushtetutës; neneve 8, 20 e në vijim të ligjit nr. 113/2020, "Për shtetësinë", i ndryshuar, me propozim të ministrit të Punëve të Brendshme,

DEKRETOJ:

Neni 1

Dhënien e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të tij, shtetasit:
1. Bennami Haci Karabey Karakuş

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj

DEKRET
Nr. 182, datë 31.3.2026

PËR DHËNIE TË SHTETËSISË SHQIPTARE

Në mbështetje të nenit 92, shkronjës "c", nenit 93 të Kushtetutës; neneve 8, 20 e në vijim të ligjit nr. 113/2020, "Për shtetësinë", i ndryshuar, me propozim të ministrit të Punëve të Brendshme,

DEKRETOJ:

Neni 1

Dhënien e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të tij, shtetasit:
1. Adjan Bujar Baraliu

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj

DEKRET
Nr. 183, datë 31.3.2026

PËR DHËNIE TË SHTETËSISË SHQIPTARE

Në mbështetje të nenit 92, shkronjës "c", nenit 93 të Kushtetutës; neneve 9, 20 e në vijim të ligjit nr. 113/2020, "Për shtetësinë", i ndryshuar, me propozim të ministrit të Punëve të Brendshme,

DEKRETOJ:

Neni 1

Dhënien e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të tij, shtetasit:

1. Serdar Ali Riza Oğuzay

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj

DEKRET
Nr. 184, datë 31.3.2026

PËR DHËNIE TË SHTETËSISË SHQIPTARE

Në mbështetje të nenit 92, shkronjës "c", nenit 93 të Kushtetutës; neneve 16, 20 e në vijim të ligjit nr. 113/2020, "Për shtetësinë", i ndryshuar, me propozim të ministrit të Punëve të Brendshme,

DEKRETOJ:

Neni 1

Dhënien e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të tyre, shtetasve:

1. Gentjan Xhemal Demuçaj
2. Amantia Genc Simixhiu

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj

DEKRET
Nr. 185, datë 31.3.2026

PËR DHËNIE TË SHTETËSISË SHQIPTARE

Në mbështetje të nenit 92, shkronjës "c", nenit 93 të Kushtetutës; neneve 6, 20 e në vijim të ligjit nr. 113/2020, "Për shtetësinë", i ndryshuar, me propozim të ministrit të Punëve të Brendshme,

DEKRETOJ:

Neni 1

Dhënien e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të tyre, shtetasve:

1. Liridon Xhemil Kabashi
2. Qamil Ismet Binaj

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj

DEKRET
Nr. 186, datë 31.3.2026

PËR DHËNIE TË SHTETËSISË SHQIPTARE

Në mbështetje të nenit 92, shkronjës "c", nenit 93 të Kushtetutës; neneve 6, 20 e në vijim të ligjit nr. 113/2020, "Për shtetësinë", i ndryshuar, me propozim të ministrit të Punëve të Brendshme,

DEKRETOJ:

Neni 1

Dhënien e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të tij, shtetasit:

1. Bajram Beshir Nasufi

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj

DEKRET
Nr. 187, datë 31.3.2026

PËR DHËNIE TË SHTETËSISË SHQIPTARE

Në mbështetje të nenit 92, shkronjës "c", nenit 93 të Kushtetutës; neneve 16, 20 e në vijim të ligjit nr. 113/2020, "Për shtetësinë", i ndryshuar, me propozim të ministrit të Punëve të Brendshme,

DEKRETOJ:

Neni 1

Dhënien e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të tyre, shtetasve:

1. Genti Skënder Shahaj
2. Arben Skënder Lulodhi

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj

DEKRET
Nr. 188, datë 31.3.2026

PËR DHËNIE TË SHTETËSISË SHQIPTARE

Në mbështetje të nenit 92, shkronjës "c", nenit 93 të Kushtetutës, neneve 16, 20 e në vijim të ligjit nr. 113/2020, "Për shtetësinë", i ndryshuar, me propozim të ministrit të Punëve të Brendshme,

DEKRETOJ:

Neni 1

Dhënien e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të tyre, shtetasve:

1. Alfred Muço Mançe
2. Elvis Vasil Nasto

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj

DEKRET
Nr. 189, datë 31.3.2026

PËR DHËNIE TË SHTETËSISË SHQIPTARE

Në mbështetje të nenit 92, shkronjës "c", nenit 93 të Kushtetutës; neneve 16, 20 e në vijim të ligjit nr. 113/2020, "Për shtetësinë", i ndryshuar, me propozim të ministrit të Punëve të Brendshme,

DEKRETOJ:

Neni 1

Dhënien e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të tyre, shtetasve:

1. Edlira Muhamet Qoshja
2. Valon Mevlud Kodhelaj

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj

DEKRET
Nr. 190, datë 31.3.2026

PËR DHËNIE TË SHTETËSISË SHQIPTARE

Në mbështetje të nenit 92, shkronjës "c", nenit 93 të Kushtetutës; neneve 9, 20 e në vijim të ligjit nr. 113/2020, "Për shtetësinë", i ndryshuar, me propozim të ministrit të Punëve të Brendshme,

DEKRETOJ:

Neni 1

Dhënien e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të saj, shtetases:

1. Melissa Simon Tom

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj

DEKRET
Nr. 191, datë 31.3.2026

PËR DHËNIE TË SHTETËSISË SHQIPTARE

Në mbështetje të nenit 92, shkronjës "c", nenit 93 të Kushtetutës; neneve 9, 20 e në vijim të ligjit nr. 113/2020, "Për shtetësinë", i ndryshuar, me propozim të ministrit të Punëve të Brendshme,

DEKRETOJ:

Neni 1

Dhënien e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të tij, shtetasit:

1. Qendrim Ramadan Bakija

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj

DEKRET
Nr. 192, datë 31.3.2026

PËR DHËNIE TË SHTETËSISË SHQIPTARE

Në mbështetje të nenit 92, shkronjës "c", nenit 93 të Kushtetutës; neneve 9, 20 e në vijim të ligjit nr. 113/2020, "Për shtetësinë", i ndryshuar, me propozim të ministrit të Punëve të Brendshme,

DEKRETOJ:

Neni 1

Dhënien e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të tij, shtetasit:

1. Granit Ibush Berisha

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj

URDHËR
Nr. 317, datë 26.3.2026

PËR NDALIMIN E PESHKIMIT NË LIQENIN E SHKODRËS

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102 të Kushtetutës; të pikës 1, të nenit 13, të ligjit nr. 64/2012, datë 31.5.2012, "Për peshkimin", të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Ndalimin e peshkimit me çfarëdolloj mjeti dhe metode gjuetie, si dhe mbajtjen në bord, tranzitimin në barkë, zbarkimin e qëllimtë të krapit – (*Cyprinus carpio*) në liqenin e Shkodrës, për periudhën 1.4.2026 deri më 30.4.2026.

2. Ndalimin e peshkimit me çfarëdolloj mjeti dhe metode gjuetie, si dhe mbajtjen në bord, tranzitimin në barkë, zbarkimin e qëllimtë të gjuhcës (cironkës) – *Alburnus Albidus Alborella* në liqenin e Shkodrës, për periudhën 1.4.2026 deri më 30.6.2026.

3. Për periudhën 1.4.2026 deri më 30.4.2026 lejohet të peshkohet vetëm ngjala me grepa nga subjektet e pajisura me leje peshkimi nga Organizata e Menaxhimit të Peshkimit të liqenit të Shkodrës, siç është parashikuar në Planin e Menaxhimit të Ngjalës.

4. Për periudhën 1.5.2026 deri më 30.6.2026, ndalimin e peshkimit me rrjeta në fashën bregliqenore prej 200 m nga bregu.

5. Vendbazimi i varkave të peshkimit do të jetë sipas zonave të përcaktuara nga Organizata e Menaxhimit të Peshkimit të liqenit të Shkodrës.

6. Për periudhën e lejimit të peshkimit të ngjalës, sipas pikës 3 të këtij urdhri, Organizata e Menaxhimit të Peshkimit të liqenit të Shkodrës të ketë monitorim të sasive ditore të peshkuara.

7. Peshku i sekuestruar nga peshkimi i paligjshëm groposet.

8. Për zbatimin e këtij urdhri të hartohet një Plan i Përbashkët Operativ Veprimi nga Drejtoria e Shërbimeve të Peshkimit dhe Akuakulturës në koordinim me Organizatën e Menaxhimit të Peshkimit të liqenit të Shkodrës.

9. Organizata e Menaxhimit të Peshkimit të liqenit të Shkodrës të marrë të gjitha masat e zhvendosjes së objekteve ku peshqit kanë lëshuar vezët, në rastet e rënies së nivelit të ujit në liqenin e Shkodrës.

10. Organizata e Menaxhimit të Peshkimit të liqenit të Shkodrës bashkëpunon me strukturat e qeverisjes vendore, Drejtorinë Rajonale të AKU-së Shkodër, Drejtorinë e Policisë së Rendit dhe atë Kufitare në qarkun e Shkodrës dhe Policinë Bashkiake të Shkodrës dhe Malësisë së Madhe.

11. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohen Drejtoria e Shërbimeve të Peshkimit dhe Akuakulturës dhe Organizata e Menaxhimit të Peshkimit të liqenit të Shkodrës.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I BUJQËSISË
DHE ZHVILLIMIT RURAL
Andis Salla

URDHËR
Nr. 318, datë 26.3.2026

PËR NDALIMIN E PESHKIMIT NË LIQENET E PRESPËS, FIERZËS, ULZËS DHE SHKOPETIT

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102 të Kushtetutës; të pikës 1, të nenit 13, të ligjit nr. 64/2012, datë 31.5.2012, "Për peshkimin", të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Ndalimin e peshkimit me çfarëdolloj mjeti dhe metode gjuetie, si dhe mbajtjen në bord, tranzitimin në barkë, zbarkimin të të gjitha llojeve të peshqve në liqenet e Prespës, Fierzës, Ulzës e Shkopetit, konkretisht:

a) Për gjuhcën (cironka) – *Alburnus Albidus Alborella*, prej 20 prillit deri më 20 korrik 2026;

b) Për krapin – *Cyprynus Carpio*, prej 25 prillit deri më 25 maj 2026.

2. Për periudhën 25.4.2026 deri më 25.6.2026, ndalohet peshkimi me rrjeta në fashën bregliqenore prej 150 ml nga bregu për liqenet e Prespës, Fierzës, Ulzës e Shkopetit.

3. Vendbazimi i varkave të peshkimit do të jetë në pikat e caktuara nga OMP-të përkatëse.

4. Për zbatimin e këtij urdhri të hartohet një Plan i Përbashkët Operativ Veprimi nga Drejtoria e

Shërbimeve të Peshkimit dhe Akuakulturës, në koordinim me OMP-të përkatëse që ushtrojnë aktivitete peshkimi në këto liqene.

5. OMP-të të marrin të gjitha masat e zhvendosjes së objekteve, ku peshqit kanë lëshuar vezët, në rastet e rënies së nivelit të ujit në këto liqene.

6. OMP-të bashkëpunojnë me strukturat e vetëqeverisjes vendore, drejtoritë rajonale të AKU-së, Drejtorinë e Policisë së Rendit dhe atë Kufitare të qarqeve përkatëse dhe me policitë bashkiake përkatëse.

7. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohen Drejtoria e Shërbimeve të Peshkimit dhe Akuakulturës dhe Organizata e Menaxhimit të Peshkimit të liqeneve të Prespës, Fierzës, Ulzës e Shkopetit.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL
Andis Salla

URDHËR
Nr. 321, datë 26.3.2026

PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË URDHRIN NR. 113, DATË 15.3.2022, "PËR MIRATIMIN E RREGULLORES PËR MASAT MBROJTËSE KUNDËR DËMTUESVE TË BIMËVE", I NDRYSHUAR

Në zbatim të nenit 102, pika 4 të Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë, të pikës 3, të nenit 14, të ligjit nr. 105/2016, "Për mbrojtjen e bimëve", të ndryshuar,

URDHËROJ:

Në rregulloren "Për masat mbrojtëse kundër dëmtuesve të bimëve", miratuar me urdhrin nr. 113, datë 15.3.2022, bëhen shtesat dhe ndryshimet e mëposhtme:

1. Në nenin 2, pas shkronjës "p" shtohen shkronjat "q" dhe "r" me këtë përmbajtje:

"q) "Mostër" është një pjesë ose sasi e vogël e bimëve, produkteve bimore dhe objekteve të tjera që përfaqëson të gjithë sasinë e bimëve, produkteve bimore dhe objekteve të tjera nga është marrë, dhe përdoret për testim;

r) "Polen" është pjesë bimore, e destinuar për mbjellje.".

2. Pas kreut VIII shtohet kreu IX, me përmbajtjen si vijon:

"KREU IX
KËRKESAT SPECIFIKE PËR IMPORTIN DHE LËVIZJEN BRENDA TERRITORIT TË VENDIT I BIMËVE TË SPECIFIKUARA DHE PËRJASHTIMET

Neni 24
Masat specifike për hyrjen brenda territorit të Republikës së Shqipërisë të prerjeve të parrënjosura për mbjellje të *Calibrachoa* spp., *Petunia* spp. dhe hibrideve të tyre, me origjinë nga Guatemala

1. Përkufizimet e mëposhtme zbatohen vetëm për qëllimet e këtij neni:

a) "Dëmtues i specifikuar" është *Bactericera cockerelli* (Šulc.), *Bemisia tabaci* Genn., *Chloridea virescens* Fabricius, *Eotetranychus lewisi* (McGregor), *Epitrix cucumeris* (Harris), *Epitrix subcrinita* (Lec.), *Helicoverpa zea* (Boddie), *Liriomyza huidobrensis* (Blanchard), *Liriomyza sativae* Blanchard, *Liriomyza trifolii* (Burgess), Pepper golden mosaic virus, Pepper huasteco yellow vein virus, *Ralstonia pseudosolanacearum* Safni *et al.*, *Ralstonia solanacearum* (Smith) Yabuuchi et al. Emend. Safni et al., *Spodoptera ornithogalli* Guenée, Squash leaf curl virus dhe Tomato severe leaf curl virus;

b) "Bimë të specifikuara" janë prerje të parrënjosura të destinuara për mbjellje të llojeve *Calibrachoa* spp., *Petunia* spp. dhe hibrideve të tyre, të rritura në Guatemala dhe të prejardhura drejtpërdrejt nga bimë mëmë të importuara nga Bashkimi Evropian.

2. Përjashtimisht nga rreshti nr. 18, i aneksit VI të kësaj rregulloreje, lejohet hyrja brenda territorit të Shqipërisë të bimëve të specifikuara të këtij neni, me kusht që të përmbushen kërkesat e përcaktuara në pikën 3 të këtij neni.

3. Kërkesat për hyrjen dhe lëvizjen brenda territorit të vendit të bimëve të specifikuara sipas këtij neni, janë si më poshtë:

3.1 Bimët e specifikuara të këtij neni hyjnë brenda territorit të vendit vetëm nëse plotësohen të gjitha kërkesat e mëposhtme:

a) Përpara fillimit të tregtisë, SPMB-ja në ministri është informuar me shkrim nga Organizata Kombëtare për Mbrojtjen e Bimëve, këtu e në vijim NPPO-ja e Guatemalës për listën që i ka dorëzuar Komisionit të BE-së, të masave që do ndërmerren për të siguruar përmbushjen e kërkesave të përcaktuara në pikën 1, të aneksit XIX bashkëlidhur kësaj rregulloreje;

b) SPMB-ja në ministri, deri më 31 dhjetor të çdo viti, është informuar me shkrim nga NPPO-ja e Guatemalës për listën që i ka dorëzuar Komisionit të BE-së me vendndodhjet e prodhimit, me kodet përkatëse të gjurmueshmërisë, që janë miratuar për të eksportuar bimët e specifikuara drejt Bashkimit Evropian për vitin kalendarik pasardhës dhe për çdo ndryshim në atë listë;

c) SPMB-ja në ministri deri më 31 mars të çdo viti vendoset në dijeni nga NPPO-ja e Guatemalës, për raportin vjetor që i ka dorëzuar Komisionit të Bashkimit Evropian, mbi aktivitetet e kryera gjatë vitit kalendarik paraardhës, që përmban të gjitha elementet e përcaktuara në pikën 2, të aneksit XIX të kësaj rregulloreje.

3.2 Për të lejuar hyrjen e bimëve të specifikuara në territorin e Shqipërisë, operatori profesionist importues paraqet një dokument të lëshuar nga AKVMB-ja, e cili konfirmon se operatori profesionist që i pranon bimët e specifikuara, përmbush kërkesat e përcaktuara në nënpikën 3.3, të pikës 3, të këtij neni.

3.3 Pas hyrjes në territorin e vendit tonë, bimët e specifikuara mund të lëvizin vetëm në:

a) ambientet e operatorëve profesionistë të cilët janë të miratuar për të lëshuar pasaportë bimore për bimët e specifikuara të rrënjosura ose të rritura; ose

b) ambientet e operatorëve profesionistë për të cilët AKVMB-ja lëshon pasaportë bimore për bimët e specifikuara.

Përpara se të marrin bimët e specifikuara, operatorët profesionistë të përmendur në këtë pikë njoftojnë AKVMB-në për datën e pritshme të mbërritjes së bimëve dhe mbajnë kodin e gjurmueshmërisë, të përmendur në nënndarjen "iii", të shkronjës "c", të pikës 1, të aneksit XIX të kësaj rregulloreje.

3.4 Bimët që janë rrënjosur ose rritur drejtpërdrejt nga bimët e specifikuara mbahen të ndara nga çdo bimë tjetër e ndjeshme ndaj dëmtuesve të specifikuar. Ato i nënshtrohen inspektimeve zyrtare të paktën një herë përpara se të lëvizin për herë të parë jashtë ambienteve të operatorit profesionist përkatës dhe sa më afër kohës së lëvizjes së tyre. Në rast dyshimi për infektim, inspektimet përfshijnë marrjen e mostrave dhe testime molekulare për viruset *Pepper golden mosaic virus*, *Pepper huasteco yellow vein virus*, *Squash leaf curl virus* dhe *Tomato severe leaf curl virus*.

Në rast zbulimi të dëmtuesve të specifikuar në bimët e specifikuara të rrënjosura ose të rritura, të paktën të gjitha bimët që rrjedhin nga i njëjti lot i bimëve të specifikuara asgjësohen menjëherë, dhe nëse është e përshtatshme, ambientet përkatëse pastrohen dhe dezinfektohen.

3.5 AKVMB-ja dhe AKU-ja njoftojnë menjëherë SPMB-në për çdo zbulim të pranisë së një dëmtuesi të specifikuar në bimët e specifikuara ose në bimët e rrënjosura apo të rritura prej tyre. SPMB-ja informon menjëherë për këtë NPPO-në e Guatemalës.

Këto bimë të përfshira në listën e miratuar sipas shkronjës "b", të nënpikës 3.1 të këtij neni, ndalohen të futen në territorin e Republikës së Shqipërisë derisa të vërtetohet se është rikthyer pastërtia nga dëmtuesit nga NPPO-ja e Guatemalës.

Neni 25

Masat specifike për hyrjen brenda territorit të Republikës së Shqipërisë të prerjeve të parrënjosura për mbjellje të *Calibrachoa* spp., *Petunia* spp. dhe hibridëve të tyre nga Kenia

1. Përkufizimet e mëposhtme zbatohen vetëm për qëllimet e këtij neni:

a) "Dëmtues të specifikuar" është *Aleurodicus disperses* Russell, *Bemisia tabaci* Genn. (popullatat jo-evropiane), Cowpea mild mottle virus, *Liriomyza huidobrensis* (Blanchard), *Liriomyza sativae* Blanchard, *Liriomyza trifolii* (Burgess), *Nipaecoccus viridis* (Newstead), Pepper veinal mottle virus, Potato leafroll virus, *Ralstonia pseudosolanacearum* Safni *et al., Ralstonia solanacearum* (Smith) Yabuuchi *et al.* Emend. Safni *et al.*, *Scirtothrips dorsalis* Hood, *Tetranychus neocaledonicus* André, *Tomato mild mottle virus* dhe *Tomato yellow ring virus*;

b) "Bimë të specifikuara" janë prerje pa rrënjë të destinuara për mbjellje të llojeve *Calibrachoa* spp. dhe *Petunia* spp. dhe hibridëve të tyre, të rritura në Kenia

dhe të prejardhura drejtpërdrejt nga bimë mëmë të importuara nga Bashkimi Evropian.

2. Përjashtimisht nga rreshti nr. 18, i aneksit VI të kësaj rregulloreje, lejohet hyrja brenda territorit të Shqipërisë të bimëve të specifikuara të këtij neni, me kusht që të përmbushen kërkesat e përcaktuara në pikën 3 të këtij neni.

3. Kërkesat për hyrjen dhe lëvizjen brenda territorit të Shqipërisë të bimëve të specifikuara sipas këtij neni, janë si më poshtë:

3.1 Bimët e specifikuara hyjnë brenda territorit të Shqipërisë vetëm nëse plotësohen të gjitha kërkesat e mëposhtme:

a) Përpara fillimit të tregtisë, SPMB-ja në ministri është informuar me shkrim nga Organizata Kombëtare për Mbrojtjen e Bimëve, këtu e në vijim NPPO-ja e Kenias për listën që i ka dorëzuar Komisionit të BE-së, të masave që do ndërmerren për të siguruar përmbushjen e kërkesave të përcaktuara në pikën 1, të aneksit XX bashkëlidhur kësaj rregulloreje;

b) SPMB-ja në ministri, deri më 31 dhjetor të çdo viti, është informuar me shkrim nga NPPO-ja e Kenias për listën që i ka dorëzuar Komisionit të BE-së me vendndodhjet e prodhimit, me kodet përkatëse të gjurmueshmërisë, që janë miratuar për të eksportuar bimët e specifikuara drejt Bashkimit Evropian për vitin kalendarik pasardhës, dhe për çdo ndryshim në atë listë;

c) SPMB-ja në ministri, deri më 31 mars të çdo viti vendoset në dijeni nga NPPO-ja e Kenias për raportin vjetor që i ka dorëzuar Komisionit të Bashkimit Evropian, mbi aktivitetet e kryera gjatë vitit kalendarik paraardhës, që përmban të gjitha elementet e përcaktuara në pikën 2, të aneksit XX të kësaj rregulloreje.

3.2 Për të lejuar hyrjen e bimëve të specifikuara në territorin e Shqipërisë, operatori profesionist importues paraqet një dokument të lëshuar nga AKVMB-ja, që konfirmon se operatori profesionist që pranon bimët e specifikuara plotëson kërkesat e përcaktuara në nënpikën 3.3, të pikës 3 të këtij neni.

3.3 Pas hyrjes në territorin e vendit, bimët e specifikuara mund të lëvizin vetëm në:

a) ambientet e operatorëve profesionistë të cilët janë të miratuar për të lëshuar pasaportën bimore për bimët me rrënjë ose të kultivuara nga bimë të specifikuara; ose

b) ambientet e operatorëve profesionistë për të cilët autoritetet kompetente lëshojnë pasaportën bimore për bimët e specifikuara.

Përpara se të marrin bimët e specifikuara, operatorët profesionistë të përmendur në shkronjën "b" të kësaj nënpike, informojnë autoritetet kompetente për datën e pritur të mbërritjes së atyre bimëve dhe duhet të ruajnë kodin e gjurmueshmërisë të përmendur në nënndarjen "iii", të shkronjës "c", të pikës 1, të aneksit XX bashkëlidhur kësaj rregulloreje.

3.4 Bimët që janë drejtpërdrejt të rrënjosura ose të kultivuara nga bimët e specifikuara mbahen të ndara nga çdo bimë tjetër e ndjeshme ndaj dëmtuesve të specifikuar. Ato i nënshtrohen inspektimeve zyrtare të paktën një herë para se të lëvizin për herë të parë jashtë ambienteve të operatorit profesionist përkatës dhe sa më afër me kohën e lëvizjes. Këto inspektime përfshijnë, në rast dyshimi për infeksion, marrjen e mostrave dhe testimin molekular për *Cowpea mild mottle virus*, *Pepper veinal mottle virus*, *Potato leafroll virus*, *Tomato mild mottle virus* dhe *Tomato yellow ring virus*.

Në rast të gjetjes së dëmtuesve të specifikuar në bimët e rrënjosura ose të kultivuara nga bimët e specifikuara, të paktën të gjitha bimët e rrënjosura ose të kultivuara nga e njëjta ngarkesë e bimëve të specifikuara shkatërrohen menjëherë, dhe nëse është e përshtatshme, ambientet përkatëse pastrohen dhe dezinfektohen.

3.5 AKVMB-ja dhe AKU-ja të njoftojnë menjëherë SPMB-në për çdo gjetje të pranisë së dëmtuesve specifikuar në bimët e specifikuara, ose në bimët e rrënjosura ose të kultivuara nga bimët e specifikuara. SPMB-ja njofton menjëherë NPPO-në e Kenias për këtë.

Këto bimë të përfshira në listën e miratuar sipas shkronjës "b", të nënpikës 3.1 të këtij neni, ndalohen të futen në territorin e Republikës së Shqipërisë derisa të vërtetohet se është rikthyer pastërtia nga dëmtuesit nga NPPO-ja e Kenias.

Neni 26

Përcaktimi i masave të përkohshme në lidhje me zhardhokët e *Solanum tuberosum* L., përveç atyre të destinuara për mbjellje, me origjinë nga Egjipti, për të parandaluar hyrjen në territorin e Republikës së Shqipërisë të *Ralstonia solanacearum* (Smith) Yabuuchi *et al.* emend. Safni *et al*

1. Përkufizimet e mëposhtme zbatohen vetëm për qëllimet e këtij neni:

a) "Dëmtues i specifikuar" është *Ralstonia solanacearum* (Smith) Yabuuchi *et al.* emend. Safni *et al.*;

b) "Bimët e specifikuara" janë zhardhokët e *Solanum tuberosum* L., përveç atyre të destinuar për mbjellje, me origjinë nga Egjipti dhe të destinuara për eksport në vendin tonë;

c) "Zonë pa dëmtues" është një zonë e krijuar nga organizata kombëtare e mbrojtjes së bimëve (NPPO) e Egjiptit si e pastër nga dëmtuesi i specifikuar, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare për Masat Fitosanitare ISPM 4 dhe ISPM 10;

ç) "Vendndodhja e prodhimit" është një vendndodhje prodhimi që menaxhohet si njësi e veçantë për qëllime fitosanitare, identifikuar me kodin e saj zyrtar individual dhe e vendosur në zonë pa dëmtues.

2. Përjashtimisht nga rreshti 21, i aneksit VII të kësaj rregulloreje, bimët e specifikuara sipas kuptimit të këtij neni, hyjnë brenda territorit të Shqipërisë, vetëm kur:

a) janë përmbushur kërkesat specifike të përcaktuara në pjesën A, të seksionit 1, të aneksit XXI, të kësaj rregulloreje;

b) në rast dyshimi për praninë ose prani të konfirmuar të dëmtuesit të specifikuar në vendndodhjet e prodhimit dhe burimet e ujit në Egjipt, janë përmbushur kërkesat e përcaktuara në pjesën B, të seksionit 1, të aneksit XXI;

c) janë përmbushur kërkesat e nënpikës 5.1, të pikës 5 të këtij neni;

ç) nëse zbatohet, janë marrë masat e përcaktuara në pikën 6 të këtij neni.

3. Certifikata fitosanitare për hyrjen brenda territorit të Shqipërisë të bimëve të specifikuara duhet të përfshijë, në rubrikën "Deklaratë shtesë", të gjitha elementet e mëposhtme:

a) Deklaratën në përputhje me kërkesat e nenit 26 të kësaj rregulloreje;

b) numrin për secilin lot të eksportuar të bimëve të specifikuara;

c) kodin e vendndodhjes së prodhimit në origjinë të secilit lot bimësh të specifikuara, sipas shkronjës "a", të nënpikës 5.1, të pikës 5 të këtij neni;

ç) emrin dhe numrin e identifikimit të stacionit/ stacioneve të ambalazhimit dhe eksportuesit/ve zyrtarisht të miratuar, sipas shkronjave "b" dhe "c", të nënpikës 5.1, të pikës 5 të këtij neni.

4. Kontrollet, marrja e mostrave dhe testimet që kryhen nga institucionet përgjegjëse janë si më poshtë:

4.1 Pa cenuar nenin 18 të kësaj rregulloreje dhe pjesën A, të seksionit III të planit shumëvjeçar të monitorimit të dëmtuesve me bazë risku 2025–2028, bimët e specifikuara i nënshtrohen kontrolleve fizike sipas nënpikave 4.2 deri në 4.7 të kësaj pike.

4.2 Marrja e mostrave për testimin e loteve që vijnë nga një vendndodhje prodhimi kryhet sipas procedurës së mëposhtme, të paktën kur këto lote hyjnë për herë të parë në Shqipëri gjatë vitit përkatës:

a) të paktën një mostër merret nga një lot nga secila vendndodhje prodhimi;

b) një mostër përbëhet nga të paktën 200 bimë të specifikuara për lot;

c) nëse, në një ngarkesë, pesha totale e loteve që vijnë nga e njëjta vendndodhje prodhimi si loti i përmendur në shkronjën "a" të kësaj nënpike tejkalon 200 ton, merret një mostër shtesë nga një lot tjetër nga ai i përmendur në shkronjën "a" të kësaj nënpike.

4.3 Inspektimet vizuale të zhardhokëve me prerje kryhen për çdo ngarkesë, si më poshtë:

a) së paku merret një mostër nga një lot nga secila vendndodhje prodhimi përfaqësuese në ngarkesë;

b) një mostër përbëhet nga të paktën 200 bimë të specifikuara për lot;

c) nëse, në një ngarkesë, pesha totale e loteve nga e njëjta vendndodhje prodhimi, si loti i përmendur në shkronjën "a" të kësaj nënpike tejkalon 200 ton, merret një mostër shtesë nga një lot tjetër nga ai i përmendur shkronjën "a" të kësaj nënpike

ç) në rast se gjatë inspektimit vizual vërehen zhardhokë të prerë me simptoma, ato merren për testim laboratorik.

4.4 Testimi i bimëve të specifikuara kryhet në përputhje me skemën e testimit të aneksit I, të udhëzimit nr. 24, datë 20.9.2024, "Për rregullat për

masat e veçanta të kontrollit për çrrënjosjen dhe për parandalimin e përhapjes brenda vendit të kalbëzimit kaf *Ralstonia solanacearum* (Smith 1896) Yabuuchi et al. 1996 emend Safni et al. 20141", i ndryshuar.

4.5 Gjatë inspektimeve vizuale, marrjes së mostrave dhe testimeve, dhe deri në marrjen e rezultateve, të gjithë lotet e bimëve të specifikuara që vijnë nga e njëjta vendndodhje prodhimi, duke përfshirë edhe ato të vendosura në ngarkesa të ndryshme nga ngarkesa e lotit të testuar, që arrijnë në të njëjtën pikë kontrolli kufitar, mbeten nën mbikëqyrjen zyrtare të institucionit përgjegjës.

4.6 Në rast konfirmimi të pranisë së dëmtuesit të specifikuar, të gjithë lotet e bimëve të specifikuara që vijnë nga e njëjta vendndodhje prodhimi, përfshirë ato në ngarkesa të ndryshme nga ngarkesa e lotit të testuar, nuk do të lejohen të hyjnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.

5. Procedura për dorëzimin e listave pranë SPMB-së dhe institucioneve të tjera përgjegjëse:

5.1 Bimët e specifikuara lejohen të hyjnë në territorin e Republikës së Shqipërisë vetëm nëse NPPO-ja e Egjiptit i ka dorëzuar SPMB-së në ministri, për qëllime të kontrolleve zyrtare në Pikat e Inspektimit Kufitar, listën e mëposhtme, e cila duhet të jetë identike me listën e vlefshme të dorëzuar pranë Komisionit Evropian dhe që lidhet me vitin e prodhimit në Egjipt. Kjo listë paraqitet përpara fillimit të sezonit të eksportit të çdo viti dhe jo më vonë se data 30 nëntor e atij viti dhe përmban:

a) listën e kodeve të të gjitha vendndodhjeve të miratuara të prodhimit dhe zonat përkatëse të pastra nga dëmtuesi;

b) listën e emrave dhe numrave të identifikimit të të gjithë eksportuesve zyrtarisht të miratuar të bimëve të specifikuara;

c) listën e emrave dhe numrave të identifikimit të të gjithë stacioneve zyrtarisht të miratuara të ambalazhimit.

5.2 SPMB-ja i dorëzon institucioneve përgjegjëse për shëndetin bimëve listat e referuara në nënpikën 5.1 të kësaj pike, në shkronjën "b", të nënpikës 6.1, të pikës 6, dhe shkronjën "c", të pikës 3, të pjesës B, të aneksit I të kësaj rregulloreje.

6. Masat që merren në rast konfirmimi të pranisë së dëmtuesit të specifikuar në bimët e specifikuara gjatë kontrolleve të importit, janë si më poshtë:

6.1 Kur prania e dëmtuesit të specifikuar në bimët e specifikuara është konfirmuar gjatë kontrolleve të importit të kryera nga institucioni përgjegjës, ngarkesat e tjera të bimëve të specifikuara që vijnë nga e njëjta vendndodhje prodhimi nuk do të lejohet të hyjnë në territorin e Republikës së Shqipërisë dhe SPMB-ja informon menjëherë NPPO-në e Egjiptit për marrjen e menjëhershme për masat e mëposhtme:

a) heqja nga lista e kodit të vendndodhjeve të prodhimit përkatës, sipas asaj që parashikohet në shkronjën "a", të nënpikës 5.1, të pikës 5 të këtij neni;

b) dorëzimi te SPMB-ja në ministri i një liste të përditësuar që reflekton ndryshimet e bëra;

c) ndalimi i eksportit të bimëve të specifikuara nga vendndodhja e prodhimit të hequr në territorin e vendit tonë.

6.2 Pas hetimeve nga NPPO-ja e Egjiptit, në rastet kur ekzistojnë prova që prania e dëmtuesit nuk lidhet me një vendndodhje prodhimi specifik, vendndodhja e prodhimit përkatës mund të rifutet në listën e referuar në shkronjën "a", të nënpikës 5.1, të pikës 5 të këtij neni.

6.3 Asnjë bimë e specifikuar me origjinë nga një vendndodhje prodhimi e hequr nga lista, siç përcaktohet në shkronjën "a", të nënpikës 6.1 të kësaj pike dhe shkronjat "a" dhe "b", të pikës 3,, të pjesës B, të seksionit I, të aneksit XXI të kësaj rregulloreje, nuk do të lejohet të hyjnë në territorin e vendit tonë gjatë vitit në fjalë dhe gjatë tri viteve pasuese. Hyrja e bimëve të specifikuara nga një vendndodhje prodhimi të hequr do të lejohet nga viti i katërt pas vitit në fjalë, dhe vetëm nëse mungesa e dëmtuesit është konfirmuar nga NPPO-ja e Egjiptit gjatë tri viteve para vitit në fjalë.

7. Në rast riambalazhimi të bimëve të specifikuara brenda territorit të vendit, operatorët profesionistë sigurojnë që çdo ambalazhi t'i bashkëngjitet një etiketë e përshtatshme, e cila të tregojë origjinën e bimëve nga Egjipti dhe ndalimin e mbjelljes së tyre në territorin kombëtar.

8. Operatorët profesionistë ndërmarrin masa të përshtatshme higjienike për hedhjen e mbetjeve që rezultojnë nga ambalazhimi, riambalazhimi ose përpunimi i bimëve të specifikuara, me qëllim parandalimin e përhapjes së dëmtuesit të specifikuar, i cili mund të jetë i pranishëm në formë latente.

Këto masa përfshijnë:

a) trajtim të përshtatshëm të të gjithë ujërave të prodhuar nga larja dhe përpunimi i bimëve të

specifikuara para se të hidhen në ujërat sipërfaqësore ose ujërat e vaditjes;

b) masa parandaluese për përhapjen në tokat bujqësore të dheut ngjitës të patrajtuar, mbetjeve të patates dhe patateve të refuzuara".

3. Në aneksin VI bëhen ndryshime si më poshtë:

Në rreshtin nr. 18, tek kolona "Përshkrimi", formulimi "Bimët për mbjelljen e *Solanaceae* përveç farave dhe bimëve të përfshira në pikat 15, 16 ose 17", zëvendësohet me formulimin si vijon:

"Bimë për mbjellje të familjes *Solanaceae*, përveç farave dhe bimëve të përfshira në pikat 15, 16 ose 17 [1]. [1] Përjashtuar bimët sipas përcaktimit të neneve 24 dhe 25 të kësaj rregulloreje, të cilat duhet të përmbushin kërkesat e përcaktuara në ato nene. ".

4. Në aneksin VII bëhen ndryshime si më poshtë:

1. Në rreshtin nr. 21, tek kolona "Përshkrimi" formulimi "Zhardhokët e *Solanum tuberosum L.*, përveç atyre për mbjellje.", zëvendësohet me formulimin si vijon:

"Zhardhokë të *Solanum tuberosum* L., përveç atyre për mbjellje [1]". [1] Përjashtuar ato me origjinë nga Egjipti që plotësojnë kërkesat e nenit 26 të kësaj rregulloreje.".

2. Pas rreshtit nr. 74 shtohet rreshti me nr. 74.1 me formulimin si vijon:

74.1	Bimët për mbjellje të *Glycine max* L. Merr., *Phaseolus coccineus* L., *Phaseolus lunatus* L., *Phaseolus vulgaris* L., *Vigna angularis* (Willd.) Ohwi & H.Ohashi, *Vigna mungo* (L.) Hepper, *Vigna radiata* (L.) R.Wilczek, *Vigna unguiculata* (L.) Walp. dhe *Vicia faba* L. (Do zbatohet deri më 23 prill 2026.)	ex 0602 90 30 ex 0602 90 50 ex 0602 90 99 ex 0713 31 00 ex 0713 32 00 0713 33 10 ex 0713 35 00 ex 0713 39 00 ex 0713 50 00 ex 0713 90 00 1201 10 00	Të gjitha vendet	Deklaratë zyrtare që: a) bimët për mbjellje kanë origjinë nga një vend i njohur si i pastër nga *Curtobacterium flaccumfaciens* pv. *flaccumfaciens* (Hedges) Collins dhe Jones, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare për Masat Fitosanitare përkatëse; ose b) bimët për mbjellje kanë origjinë nga një zonë e caktuar nga organizata kombëtare e mbrojtjes së bimëve në vendin e origjinës si zonë e pastër nga *Curtobacterium flaccumaciens* pv. *flaccumfaciens* (Hedges) Collins dhe Jones, në përputhje me Standardin Ndërkombëtar për Masat Fitosanitare ISPM 4; zona e pastër nga dëmtuesi përmendet në certifikatën fitosanitare; ose c) bimët për mbjellje kanë origjinë nga një vendndodhje prodhimi që përmbush kushtet e mëposhtme: i. është i regjistruar dhe i mbikëqyrur nga organizata kombëtare e mbrojtjes së bimëve në vendin e origjinës; ii. është kryer inspektim zyrtar i vendndodhjes së prodhimit dhe zonës së afërt para se të bëhet korrja, dhe nuk është konstatuar praninë e *Curtobacterium flaccumfaciens* pv. *flaccumfaciens* (Hedges) Collins dhe Jones; iii. para eksportit, është testuar një mostër përfaqësuese e bimëve për mbjellje me metoda të përshtatshme dhe identifikim molekular dhe janë gjetur të pastra nga *Curtobacterium flaccumfaciens* pv. *flaccumfaciens* (Hedges) Collins dhe Jones; ose d) në rastin e bimëve për mbjellje në formë farash, para eksportit, nga çdo lot është marrë mostër e cila është testuar me metoda të përshtatshme dhe identifikim molekular dhe

				është gjetur e pastër nga *Curtobacterium flaccumfaciens* pv. *flaccumfaciens* (Hedges) Collins dhe Jones. Në rastin e pikës "d", madhësia e mostrës duhet të jetë e tillë që të mundësojë zbulimin e nivelit të infeksionit prej të paktën 0.5 % me një nivel besueshmërie prej 99 %. Megjithatë, për lotet e farave më të vogla se 8,000 fara, është testuar një mostër përfaqësuese prej 10 % të lotit dhe është gjetur e pastër nga *Curtobacterium flaccumfaciens* pv. *flaccumfaciens* (Hedges) Collins dhe Jones në këtë test.

5. Në aneksin IX bëhen ndryshimet si vijon:

1. Në pjesën A, pas pikës "8. Farat e:" shtohet formulimi i mëposhtëm:

Phaseolus lunatus L., *Vigna angularis* (Willd.) Ohwi & H.Ohashi, Vigna mungo (L.) Hepper, and *Vigna radiata* (L.) R.Wilczek, *Vigna unguiculata* (L.) Walp. (Do zbatohet deri më 23 prill 2026.)	Farat e bimëve të specieve *Vigna mungo* (L.) Hepper ose *Vigna radiata* (L.) Wilczek, *Vigna unguiculata* (L.) Walp. për mbjellje: **ex 0713 31 00** **ex 0713 35 00** Farat e fasuleve të vogla të kuqe (Adzuki) (Vigna angularis) për mbjellje: **ex 0713 32 00** Fasule (*Phaseolus lunatus*, *Phaseolus coccineus*) për mbjellje: -- Tjera **ex 0713 39 00**	Të gjitha vendet përveç Zvicrës.

2. Në pjesën B, në kolonën e dytë, "Kodi NK" me formulimin "Perime bishtajore të thata, të pa lëvozhga, pa lëkura apo të ndara, për mbjellje:

ex 0713 20 00
ex 0713 31 00
ex 0713 32 00
ex 0713 34 00
ex 0713 35 00
ex 0713 39 00
ex 0713 40 00
ex 0713 60 00
ex 0713 90 00

zëvendësohet me tekstin e mëposhtëm:

	Perime leguminoze të thata, të shkëputura nga bishti, pa u qëruar ose ndarë, për mbjellje [1]: **ex 0713 20 00** **ex 0713 34 00** **ex 0713 39 00** **ex 0713 40 00** **ex 0713 60 00** **ex 0713 90 00** *(Përveç Phaseolus lunatus dhe Phaseolus coccineus).* [1] Do zbatohet deri më 23 prill 2026.	

6. Pas aneksit XVIII shtohen anekset XIX, XX dhe XXI bashkëlidhur këtij urdhri.

7. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit, Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve, Autoriteti Kombëtar i Ushqimit dhe Instituti i Sigurisë Ushqimore dhe Veterinarisë.

8. Ky urdhër hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet 30 ditë pas hyrjes në fuqi. Shkronja "b", e pjesës A, të aneksit XXI të kësaj rregulloreje i fillon efektet nga data 1 dhjetor 2028. Nenet 24 dhe 25 zbatohen deri më datë 30 prill 2028. Neni 26 do zbatohet deri më datë 30 nëntor 2029.

MINISTËR I BUJQËSISË
DHE ZHVILLIMIT RURAL
Andis Salla

URDHËR
Nr. 340, datë 30.3.2026

PËR DISA MASA MBROJTËSE NDAJ SËMUNDJES SË INFLUENCËS AVIARE ME PATOGJENITET TË LARTË TË SHPENDËVE, TË SHFAQUR NË SHTETIN E ITALISË

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102 të Kushtetutës dhe pikës 1, të nenit 43, të ligjit nr. 10465, datë 29.9.2011, "Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Ndalimin e importit dhe tranzitimit nga zonat e përcaktuara në pikën 2 të këtij urdhri për në territorin e Republikës së Shqipërisë, të:

a) shpendëve të gjallë shtëpiakë;

b) zogjve 24-orësh;

c) shpendëve dekorativë;

ç) materialit biologjik të shpendëve;

d) vezëve të shpendëve;

dh) mishit të shpendëve të patrajtuar termikisht;

e) nënprodukteve të shpendëve të patrajtuar termikisht.

2. Zonat e prekura me sëmundjen e influencës aviare me patogjenitet të lartë të shpendëve, të shfaqur në shtetin e Italisë, janë sipas tabelës së mëposhtme:

Nr.	Ndarja administrative e nivelit 1	Ndarja administrative e nivelit 2	Ndarja administrative e nivelit 3
1	Friuli-Venezia Giulia	Udine	Povoletto*
2	Veneto	Verona	Oppeano*
3	Veneto	Verona	Isola Della Scala*
4	Piemonte	Alessandria	Occimiano*
5	Emilia-Romagna	Bologna	Minerbio*
6	Emilia-Romagna	Forli' - Cesena	Forli*
7	Emilia-Romagna	Parma	Sorbolo*
8	Lombardia	Lodi	Zelo Buon Persico*
9	Lombardia	Cremona	Casale Cremasco-Vidolasco*
10	Emilia-Romagna	Bologna	San Giovanni In Persiceto*
11	Emilia-Romagna	Modena	Soliera*
12	Emilia-Romagna	Ferrara	Voghiera*
13	Emilia-Romagna	Modena	Modena*
14	Lombardia	Brescia	Seniga*
15	Piemonte	Novara	Novara*
16	Lombardia	Mantua	Guidizzolo*
17	Lombardia	Varese	Olgiate Olona*
18	Lombardia	Mantua	Ceresara*
19	Veneto	Venezia	Mira*
20	Lombardia	Mantua	Goito*
21	Lombardia	Mantua	Marmirolo*
22	Lombardia	Mantua	Roverbella*
23	Verona	Verona	Nogarole Rocca*
24	Emilia-Romagna	Ferrara	Argenta*
25	Piemonte	Torino	Front*
26	Toscana	Pistoia	Agliana*
27	Veneto	Treviso	Fonte*
28	Emilia-Romagna	Ravenna	Lugo*
29	Veneto	Verona	Vigasio*
30	Veneto	Verona	Verona*
31	Veneto	Verona	Valeggio Sul Mincio*
32	Emilia-Romagna	Parma	Noceto*
33	Veneto	Verona	Zimella*
34	Veneto	Verona	Zevio*
35	Veneto	Verona	Villafranca Di Verona*
36	Toscana	Pisa	San Giuliano Terme*
37	Lombardia	Mantua	Volta Mantovana*
38	Veneto	Verona	Illasi*
39	Umbria	Perugia	Marsciano*
40	Toscana	Arezzo	Subbiano*
41	**Toscana**	**Florence**	**Campi Bisenzio***

Shënim. Simboli (*) nënkupton zonën e infektuar që bllokohet.

3. Certifikata veterinare garanton origjinën e ngarkesës së ardhur.

4. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit dhe Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve informon të gjithë subjektet importuese të shpendëve të gjallë shtëpiakë, zogjve 24-orësh, shpendëve dekorativë, materialit biologjik, vezëve të shpendëve, mishit të shpendëve të patrajtuar termikisht dhe nënprodukteve të shpendëve të patrajtuar termikisht për hyrjen në fuqi të këtij urdhri.

5. Ky urdhër nuk zbatohet për ngarkesat e certifikuara para datës së hyrjes në fuqi të këtij urdhri.

6. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit të informojë rregullisht Drejtorinë e Përgjithshme të Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit dhe Autoritetin Kombëtar të Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve për çdo ngarkesë të shpendëve të gjallë shtëpiakë, zogjve 24-orësh, shpendëve dekorativë, materialit biologjik, vezëve të shpendëve, mishit të shpendëve të patrajtuar termikisht dhe nënprodukteve të shpendëve të patrajtuar termikisht që vijnë nga vendet e sipërcituara sipas pikës 2 të këtij urdhri.

7. Urdhri nr. 333, datë 27.3.2026, "Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së influencës aviare me patogjenitet të lartë të shpendëve, të shfaqur në shtetin e Italisë", shfuqizohet.

8. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit, Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve dhe Autoriteti Kombëtar i Ushqimit.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

NË MUNGESË DHE ME URDHËR
ZËVENDËSMINISTËR I BUJQËSISË
DHE ZHVILLIMIT RURAL
Fatmir Guri

URDHËR
Nr. 345, datë 31.3.2026

PËR DISA MASA MBROJTËSE NDAJ SËMUNDJES SË PSEUDOPESTIT TË SHPENDËVE, TË SHFAQUR NË SHTETIN E POLONISË

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102 të Kushtetutës dhe pikës 1, të nenit 43, të ligjit nr. 10465, datë 29.9.2011, "Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Ndalimin e importit dhe tranzitimit nga zonat e përcaktuara në pikën 2 të këtij urdhri për në territorin e Republikës së Shqipërisë të:

a) shpendëve të gjallë shtëpiakë;

b) zogjve 24-orësh;

c) mishit të freskët;

ç) materialit biologjik të shpendëve të pashoqëruar me test diagnostik PCR-je të kryer 14 ditë përpara mbledhjes, që vërteton mosprezencën e virusit;

d) vezëve dhe produkteve të vezëve të shpendëve, ku nuk është siguruar shkatërrimi i virusit të pseudopestit, përkatësisht në vezën e plotë nuk është bërë trajtimi në temperaturën 55ºC në 2,521 sekonda, në vezën e lëngshme nuk është bërë trajtimi në 55ºC në 2,278 sekonda, në të verdhën e vezës me 10% kriposje nuk është bërë trajtimi me temperaturë 55ºC në 176 sekonda dhe në të bardhën e vezës së tharë nuk është bërë trajtimi në temperaturën 57ºC në 50.4 orë;

dh) produkteve të mishit të shpendëve të patrajtuar termikisht përkatësisht:

i. 65ºC në 39.8 sekonda;

ii. 70 ºC në 3.6 sekonda;

iii. 74 ºC në 0.5 sekonda;

iv. 80ºC në 0.03 sekonda;

e) nënprodukteve të shpendëve të patrajtuar termikisht.

2. Zonat e prekura me sëmundjen e pseudopestit të shpendëve, të shfaqur në shtetin e Polonisë, janë sipas tabelës së mëposhtme:

Nr.	Ndarja administrative e nivelit 1	Ndarja administrative e nivelit 2	Ndarja administrative e nivelit 3
1.	Małopolskie	Brzesko	Czchów*
2.	Śląskie	Gliwice (City)	Gliwice*
3.	Śląskie	Gliwice	Toszek*

4.	Podlaskie	Siemiatycze	Nurzec-Stacja*
5.	Podlaskie	Białystok	Łapy*
6.	Małopolskie	Tarnów	Wojnicz*
7.	Kujawsko-Pomorskie	Toruń	Chełmża (rural)*
8.	Małopolskie	Bochnia	Bochnia*
9.	Podkarpackie	Przemyśl	Krasiczyn*
10.	Warmińsko-Mazurskie	Działdowo	Iłowo-Osada*
11.	Podlaskie	Białystok	Supraśl*
12.	Lubelskie	Łęczna	Ludwin*
13.	Pomorskie	Nowy Dwór Gdański	Ostaszewo*
14.	Świętokrzyskie	Jędrzejów	Sędziszów*
15.	Mazowieckie	Wołomin	Tłuszcz*
16.	Podkarpackie	Przemyśl	Stubno*
17.	Małopolskie	Bochnia	Nowy Wiśnicz*
18.	Świętokrzyskie	Staszów	Staszów*
19.	Podkarpackie	Przemyśl	Medyka*
20.	Pomorskie	Malbork	Miłoradz*
21.	Mazowieckie	Żuromin	Bieżuń*
22.	Mazowieckie	Żuromin	Żuromin*
23.	Łódzkie	Piotrków	Wolbórz*
24.	Łódzkie	Rawa	Rawa Mazowiecka (rural)*
25.	Pomorskie	Kartuzy	Sierakowice*
26.	Mazowieckie	Gostynin	Gostynin (rural)*
27.	Mazowieckie	Sierpc	Szczutowo*
28.	Mazowieckie	Sierpc	Rościszewo*
29.	Podkarpackie	Mielec	Radomyśl Wielki*
30.	Świętokrzyskie	Kielce	Mniów*
31.	Podlaskie	Mońki	Goniądz*
32.	Wielkopolskie	Wolsztyn	Wolsztyn*
33.	Wielkopolskie	Ostrów Wielkopolski	Nowe Skalmierzyce*
34.	Kujawsko-Pomorskie	Aleksandrów	Zakrzewo*
35.	Lubuskie	Wschowa	Wschowa*
36.	Wielkopolskie	Poznań	Stęszew*
37.	Wielkopolskie	Leszno	Wijewo*
38.	Zachodniopomorskie	Białogard	Białogard (rural)*
39.	Podlaskie	Mońki	Knyszyn*
40.	Podlaskie	Sokółka	Janów*
41.	Opolskie	Opole	Niemodlin*
42.	Warmińsko-Mazurskie	Olsztyn	Jonkowo*
43.	Wielkopolskie	Wolsztyn	Przemęt*
44.	Wielkopolskie	Wolsztyn	Siedlec*
45.	Wielkopolskie	Nowy Tomyśl	Miedzichowo*
46.	Wielkopolskie	Rawicz	Miejska Górka*
47.	Wielkopolskie	Grodzisk Wielkopolski	Grodzisk Wielkopolski*
48.	Zachodniopomorskie	Gryfino	Gryfino*
49.	Wielkopolskie	Ostrów Wielkopolski	Sieroszewice*
50.	Wielkopolskie	Nowy Tomyśl	Opalenica*
51.	Małopolskie	Dąbrowa	Olesno*
52.	Podlaskie	Mońki	Krypno*
53.	Wielkopolskie	Szamotuły	Duszniki*
54.	Wielkopolskie	Poznań	Mosina*
55.	Mazowieckie	Maków	Płoniawy-Bramura*
56.	Zachodniopomorskie	Koszalin	Sianów*
57.	Wielkopolskie	Kalisz	Opatówek*
58.	Wielkopolskie	Kalisz	Lisków*
59.	Kujawsko-Pomorskie	Radziejów	Bytoń*
60.	Wielkopolskie	Środa Wielkopolska	Nowe Miasto Nad Wartą*
61.	Warmińsko-Mazurskie	Nowe Miasto	Kurzętnik*
62.	Wielkopolskie	Kalisz	Ceków-Kolonia*
63.	Wielkopolskie	Środa Wielkopolska	Zaniemyśl*
64.	Kujawsko-Pomorskie	Radziejów	Osięciny*
65.	Dolnośląskie	Milicz	Krośnice*
66.	Wielkopolskie	Kalisz	Koźminek*
67.	Warmińsko-Mazurskie	Iława	Lubawa (rural)*
68.	Łódzkie	Skierniewice	Lipce Reymontowskie*
69.	Łódzkie	Sieradz	Goszczanów*
70.	Wielkopolskie	Śrem	Śrem*
71.	Wielkopolskie	Leszno	Rydzyna*
72.	Warmińsko-Mazurskie	Nowe Miasto	Biskupiec*
73.	Łódzkie	Łowicz	Zduny*
74.	Wielkopolskie	Szamotuły	Kaźmierz*
75.	Wielkopolskie	Pleszew	Gołuchów*
76.	Mazowieckie	Płock (City)	Płock*
77.	Lubuskie	Nowa Sól	Bytom Odrzański*
78.	Zachodniopomorskie	Kamień	Golczewo*
79.	Wielkopolskie	Gostyń	Poniec*
80.	**Śląskie**	**Dąbrowa Górnicza**	**Dąbrowa Górnicza***
81.	**Lubuskie**	**Nowa Sól**	**Kożuchów***

Shënim. Simboli (*) nënkupton zonën e infektuar që bllokohet.

3. Importi dhe tranzitimi i shpendëve të gjallë shtëpiakë, zogjve 24-orësh, mishit të freskët, materialit biologjik, vezëve dhe produkteve të vezëve, produkteve të mishit të shpendëve dhe nënprodukteve të shpendëve, lejohet nga zona dhe kompartamente të shtetit të Polonisë të cilat nuk kanë pasur njoftim të sëmundjes së pseudopestit të shpendëve për 12 muajt e fundit.

4. Certifikata veterinare garanton origjinën e ngarkesës së ardhur.

5. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit informon rregullisht Drejtorinë e Përgjithshme të Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit dhe Autoritetin Kombëtar të Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve, për çdo ngarkesë të shpendëve të gjallë shtëpiakë, zogjve 24-orësh, mishit të freskët, materialit biologjik, vezëve dhe produkteve të vezëve, produkteve të mishit të shpendëve dhe nënprodukteve të shpendëve që vijnë nga zonat e sipërcituara sipas pikës 2 të këtij urdhri.

6. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit dhe Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve të informojnë të gjithë subjektet importuese të shpendëve të gjallë shtëpiakë, zogjve 24-orësh, shpendëve dekorativë, materialit biologjik, vezëve të shpendëve, mishit të shpendëve të patrajtuar termikisht dhe nënprodukteve të shpendëve të patrajtuar termikisht për hyrjen në fuqi të këtij urdhri.

7. Ky urdhër nuk zbatohet për ngarkesat e certifikuara para datës së hyrjes në fuqi të këtij urdhri.

8. Urdhri nr. 335, datë 27.3.2026, "Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së pseudopestit, të shfaqur në shtetin e Polonisë", shfuqizohet.

9. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit, Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve dhe Autoriteti Kombëtar i Ushqimit.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

NË MUNGESË DHE ME URDHËR
ZËVENDËSMINISTËR I BUJQËSISË
DHE ZHVILLIMIT RURAL
Fatmir Guri

VENDIM
Nr. 74, datë 12.3.2026

MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR SHQYRTIMIN E KËRKESËS SË SHOQËRISË "NOVA SOLAR SYSTEM" SHPK, PËR MODIFIKIMIN E LICENCËS NË VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA CENTRALI FOTOVOLTAIK ME KAPACITET TË INSTALUAR 50 mw

Në mbështetje të neneve 16 dhe 43, të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar; të neneve 10, pikat 1 dhe 3, dhe 15, pika 4 të "Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike", të miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.6.2016, të ndryshuar; si dhe të neneve 15 dhe 19, pika 1, germa "a", të "Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s", miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 12.3.2026, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 879 prot., datë 10.3.2026, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Garancisë së Origjinës, "Mbi kërkesën e shoqërisë 'Nova Solar System' sh.p.k. për modifikimin e licencës në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik me kapacitet të instaluar 50 mw",

konstatoi se:

1. Të dhëna për shoqërinë

- Shoqëria "Nova Solar System" sh.p.k., është licencuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 242, datë 3.8.2023, për prodhimin e energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik me kapacitet të instaluar 50 mw.

- Në vijim të këtij licencimi, shoqëria ka paraqitur në ERE kërkesën për saktësim në aneksin A të licencës së saj, për ndryshimin e numrit të njësive gjeneruese (panele) dhe vendosjen e pajisjeve të depozitimit të energjisë, pa ndryshuar kapacitetin total të instaluar të licencës prej 50 mw.

- Për sa i përket kërkesës së shoqërisë, ERE, me *email*-in e datës 6.3.2026, i ka sqaruar shoqërisë dokumentacionin e nevojshëm për të vijuar me shqyrtimin e kësaj kërkese për disa ndryshime dhe shtesa në aneksin A të licencës.

2. Përputhshmëria e Aplikimit me Rregulloren

- Në përputhje me nenin 15, pika 4, të "Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar, aplikuesi ka dorëzuar dokumentacionin e kërkuar për modifikimin e licencës sipas germave ("b", "d", "e", "f" dhe "g") si dhe në datën 6.3.2026, shoqëria ka kryer për llogari të ERE-s pagesën e aplikimit sipas përcaktimeve të aneksit A të rregullores.

Në këtë aplikim duhet të plotësohet dhe sa vijon:

Neni 15, "Modifikimi i Licencës":

Pika 4, Në rastin e modifikimit/ndryshimit të licencës me kërkesë të të licencuarit, ERE zbaton të njëjtat afate dhe procedura, si për licencimin duke kërkuar informacionin e mëposhtëm.

- germa "a": aplikuesi duhet të depozitojë në ERE shtojcën 1 të plotësuar në të gjithë zërat e saj;

- germa "c": aplikuesi duhet të depozitojë vendimin me shkrim të organeve drejtuese të saj, të cilat shprehin vullnetin për të kërkuar modifikimin e licencës.

Në lidhje me fillimin e procedurës për modifikimin e licencës së shoqërisë sipas kërkesës së saj, vlerësohet që të njoftohen dhe Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE), Agjencia Kombëtare e Mjedisit (AKM) dhe Operatori i Sistemit të Transmetimit (OST) sh.a.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurën për modifikimin e licencës së shoqërisë "Nova Solar System" sh.p.k., dhënë me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 242, datë 3.8.2023, për prodhimin e energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik me kapacitet të instaluar 50 mw, për ndryshimin e numrit të paneleve dhe shtimin e objekteve të depozitimit të energjisë në aneksin A të licencës.

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Garancisë së Origjinës, të njoftojë shoqërinë "Nova Solar System" sh.p.k., Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, Agjencinë Kombëtare të Mjedisit dhe Operatorin e Sistemit të Transmetimit (OST) sh.a. për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes dijeni të vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

VENDIM
Nr. 75, datë 12.3.2026

MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR SHQYRTIMIN E KËRKESËS SË SHOQËRISË "EZ-5 ENERGY" SHPK PËR MODIFIKIMIN E LICENCËS NË VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA CENTRALI FOTOVOLTAIK ME KAPACITET TË INSTALUAR 30 mw

Në mbështetje të neneve 16 dhe 43, të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar; të neneve 10, pikat 1 dhe 3, dhe 15, pika 4, të "Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike", të miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.6.2016, të ndryshuar; si dhe të neneve 15 dhe 19, pika 1, germa "a", të "Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s", miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 12.3.2026, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 485/1 prot., datë 10.3.2026, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Garancisë së Origjinës, "Mbi kërkesën e shoqërisë 'EZ-5 Energy' sh.p.k. për modifikimin e licencës në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik me kapacitet të instaluar 30 mw",

konstatoi se:

1. Të dhëna për shoqërinë

- Shoqëria "EZ-5 Energy" sh.p.k., është licencuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 171, datë 31.7.2025, për prodhimin e energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik me kapacitet të instaluar 30 mw.

- Në vijim të këtij aplikimi, shoqëria ka paraqitur në ERE kërkesën për saktësim në aneksin A të licencës së saj, duke shtuar në të dhe sistemet e akumulimit/depozitimit të energjisë, si vepra ndihmëse, pa ndryshuar kapacitetin total të centralit, prej 30 mw.

2. Përputhshmëria e aplikimit me rregulloren

- Në përputhje me nenin 15, pika 4, të "Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar, aplikuesi ka dorëzuar dokumentacionin e kërkuar për modifikimin e licencës sipas germave "b", "d", "e", "f" dhe "g"), dhe në vijim të pagesës së aplikimit të kryer në datën 6.3.2026, sipas përcaktimeve të aneksit A të rregullores.

Gjithashtu rezulton se në këtë aplikim duhet të plotësohet dhe sa vijon:

Neni 15, "Modifikimi i licencës"

Pika 4, Në rastin e modifikimit/ndryshimit të licencës me kërkesë të të licencuarit, ERE zbaton të njëjtat afate dhe procedura si për licencimin duke kërkuar informacionin e mëposhtëm.

- germa "a": aplikuesi duhet të depozitojë në ERE shtojcën 1 të plotësuar në të gjithë zërat e saj;

- germa "c": aplikuesi duhet të depozitojë vendimin me shkrim të organeve drejtuese të saj, të cilat shprehin vullnetin për të kërkuar modifikimin e licencës.

- Në lidhje me fillimin e procedurës për modifikimin e licencës së shoqërisë sipas kërkesës së saj, vlerësohet që të njoftohet dhe Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE), Agjencia Kombëtare e Mjedisit (AKM) dhe Operatori i Sistemit të Transmetimit (OST) sh.a.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurën për modifikimin e licencës së shoqërisë "EZ-5 Energy" sh.p.k., dhënë me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 171, datë 31.7.2025, për prodhimin e energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik me kapacitet të instaluar 30 mw, për shtimin e objekteve të depozitimit të energjisë në aneksin A të licencës, si vepra ndihmëse.

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Garancisë së Origjinës të njoftojë shoqërinë "EZ-5 Energy" sh.p.k., Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, Agjencinë Kombëtare të Mjedisit dhe Operatorin e Sistemit të Transmetimit (OST) sh.a. për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes dijeni të vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

VENDIM
Nr. 76, datë 12.3.2026

MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR SHQYRTIMIN E KËRKESËS SË SHOQËRISË "EZ-5 ENERGY" SHPK PËR MODIFIKIMIN E LICENCËS NË VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA CENTRALI FOTOVOLTAIK ME KAPACITET TË INSTALUAR 10 mw

Në mbështetje të neneve 16 dhe 43, të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar; të neneve 10, pikat 1 dhe 3, dhe 15, pika 4, të "Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike", të miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.6.2016, të ndryshuar; si dhe të neneve 15 dhe 19, pika 1, germa "a", të "Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s", miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 12.3.2026, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 709/1 prot., datë 11.3.2026, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Garancisë së Origjinës "Mbi kërkesën e shoqërisë 'EZ-5 Energy' sh.p.k. për modifikimin e licencës në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik me kapacitet të instaluar 10 mw",

konstatoi se:

1. Të dhëna për shoqërinë

- Shoqëria "EZ-5 Energy" sh.p.k., është licencuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 237, datë 22.9.2022, për prodhimin e energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik me kapacitet të instaluar 10 mw.

- Në vijim të këtij aplikimi, shoqëria ka paraqitur në ERE kërkesën për saktësim në aneksin A të licencës së saj, duke shtuar në të dhe sistemet e akumulimit/depozitimit të energjisë, si vepra ndihmëse, pa ndryshuar kapacitetin total të centralit, prej 10 mw.

2. Përputhshmëria e aplikimit me rregulloren

- Në përputhje me nenin 15, pika 4, të "Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike",

të ndryshuara, aplikuesi ka dorëzuar dokumentacionin e kërkuar për modifikimin e licencës sipas germave "b", "d", "e", "f" dhe "g" dhe në vijim të pagesës së aplikimit të kryer në datën 6.3.2026, sipas përcaktimeve të aneksit A të rregullores.

Gjithashtu rezulton se në këtë aplikim duhet të plotësohet dhe sa vijon:

Neni 15, "Modifikimi i licencës"

Pika 4, Në rastin e modifikimit/ndryshimit të licencës me kërkesë të të licencuarit, ERE zbaton të njëjtat afate dhe procedura si për licencimin duke kërkuar informacionin e mëposhtëm.

- germa "a": aplikuesi duhet të depozitojë në ERE shtojcën 1 të plotësuar në të gjithë zërat e saj;
- germa "c": aplikuesi duhet të depozitojë vendimin me shkrim të organeve drejtuese të saj, të cilat shprehin vullnetin për të kërkuar modifikimin e licencës.
- Në lidhje me fillimin e procedurës për modifikimin e licencës së shoqërisë sipas kërkesës së saj, vlerësohet që të njoftohet dhe Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE), Agjencia Kombëtare e Mjedisit (AKM) dhe Operatori i Sistemit të Shpërndarjes (OSSH) sh.a.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurën për modifikimin e licencës së shoqërisë "EZ-5 Energy" sh.p.k., dhënë me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 237, datë 22.9.2022, për prodhimin e energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik me kapacitet të instaluar 10 mw, për shtimin e objekteve të depozitimit të energjisë në aneksin A të licencës , si vepra ndihmëse.

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Garancisë së Origjinës, të njoftojë shoqërinë "EZ-5 Energy" sh.p.k., Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, Agjencinë Kombëtare të Mjedisit dhe Operatorin e Sistemit të Shpërndarjes (OSSH) sh.a. për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes dijeni të vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

VENDIM
Nr. 77, datë 12.3.2026

MBI MIRATIMIN E DISA NDRYSHIMEVE NË VENDIMIN E BORDIT TË ERE-s NR. 302, DATË 17.11.2025, "MBI LICENCIMIN E SHOQËRISË 'SPITALLA SOLAR' SHPK NË VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE"

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar; të nenit 113, të ligjit nr. 44/2015, "Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë"; si dhe të nenit 15, të "Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s", miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 12.3.2026, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 404/1 prot., datë 9.3.2026, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Garancisë së Origjinës të ERE-s "Mbi disa ndryshime në vendimin e Bordit të ERE-s nr. 302, datë 17.11.2025, 'Mbi licencimin e shoqërisë 'Spitalla Solar' sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike"',

konstatoi se:

1. Të dhëna mbi shoqërinë "Spitalla Solar" sh.p.k.

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 302, datë 17.11.2025, ka licencuar shoqërinë "Spitalla Solar" sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik, me kapacitet të instaluar 90 mw, me vendndodhje në Spitallë, Bashkia Durrës, qarku Durrës, për një afat 30-vjeçar.
- Në pikën 2, të vendimit nr. 302/2025, përcaktohet se: "Përpara fillimit të operimit, shoqëria duhet të depozitojë në ERE marrëveshjen e nënshkruar me shoqërinë 'Operatori Sistemit të Transmetimit' (OST) sh.a. për miratimin e pikës së lidhjes së centralit fotovoltaik me rrjetin e transmetimit".

- Gjithashtu, në pikën 5, të vendimit nr. 302/2025, përcaktohet se: "Ky vendim është objekt rishikimi, në rast të plotësimit/mosplotësimit të kushteve të vendosura në pikat 2, 3 dhe 4, të këtij vendimi dhe në rast të depozitimit të akteve të ndryshme nga ato që kanë shërbyer për marrjen e këtij vendimi".

2. Korrespondenca dhe dokumentacioni i depozituar nga shoqëria

- ERE ka njoftuar shoqërinë për vendimin e Bordit nr. 302/2025 me shkresën nr. 2403/15 prot., datë 21.11.2025, duke i sjellë në vëmendje dhe plotësimin e kushteve të këtij vendimi.

- Me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 404 prot., datë 28.1.2026, shoqëria ka depozituar "Marrëveshjen për lidhjen me rrjetin e transmetimit të parkut fotovoltaik Spitalla Solar", të nënshkruar më 19.1.2026, ndërmjet "OST" sh.a. dhe shoqërisë "Spitalla Solar" sh.p.k.

3. Analiza ligjore dhe vlerësimi

- Me depozitimin nga shoqëria të "Marrëveshjes për lidhjen me rrjetin e transmetimit të parkut fotovoltaik Spitalla Solar" të nënshkruar me "OST" sh.a., rezulton se është plotësuar kushti i vendosur në pikën 2, të vendimit të ERE-s nr. 302/2015, ndaj kjo pikë e vendimit vlerësohet të shfuqizohet.

4. Nevoja për ndryshimin e vendimit

- Në nenin 113, të ligjit nr. 44/2015, "Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë", parashikohet se një akt administrativ mund të ndryshohet, shfuqizohet apo anulohet, kryesisht nga organi publik që ka kompetencë për ta nxjerrë atë.

- Në vijim të shfuqizimit të pikës 2, të vendimit nr. 302/2025, vlerësohet i nevojshëm edhe ndryshimi i pikës 5 të këtij vendimi, i cili përcakton se ky vendim është objekt rishikimi nga ERE, duke e riformuluar si vijon: "Ky vendim është objekt rishikimi, në rast të plotësimit/mosplotësimit të kushteve të vendosura në pikat 3 dhe 4, të këtij vendimi dhe në rast të depozitimit të akteve të ndryshme nga ato që kanë shërbyer për marrjen e këtij vendimi".

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Miratimin e disa ndryshimeve në vendimin e ERE-s nr. 302, datë 17.11.2025, si vijon:

a) Pika 2, e vendimit të ERE-s nr. 302, datë 17.11.2025, shfuqizohet.

b) Pika 5, e vendimit të ERE-s nr. 302, datë 17.11.2025, ndryshon dhe bëhet: "Ky vendim është objekt rishikimi, në rast të plotësimit/mosplotësimit të kushteve të vendosura në pikat 3 dhe 4, të këtij vendimi dhe në rast të depozitimit të akteve të ndryshme nga ato që kanë shërbyer për marrjen e këtij vendimi.".

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Garancisë së Origjinës të njoftojë shoqërinë "Spitalla Solar" sh.p.k. dhe Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes dijeni të vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

VENDIM
Nr. 78, datë 12.3.2026

MBI MIRATIMIN E KËRKESËS SË SHOQËRISË "NOA ENERGY TRADE" SHPK PËR KRIJIMIN E LLOGARISË NË REGJISTRIN ELEKTRONIK TË GARANCIVE TË ORIGJINËS

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar; të nenit 22, të ligjit nr. 24/2023, "Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme"; të nenit 6, të "Rregullores për lëshimin, transferimin, shlyerjen dhe anulimin e garancive të origjinës për energjinë elektrike të prodhuar nga burimet e rinovueshme", miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 300, datë 30.12.2024; si dhe të nenit 15, të "Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-

s", miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 12.3.2026, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Garancisë së Origjinës, me nr. 826/1 prot., datë 9.3.2026, "Mbi shqyrtimin e kërkesës së shoqërisë 'Noa Energy Trade' sh.p.k. për krijimin e llogarisë në regjistrin elektronik të garancive të origjinës",

konstatoi se:

1. Të dhëna mbi shoqërinë "Noa Energy Trade" sh.p.k.

- Shoqëria "Noa Energy Trade" sh.p.k. është licencuar në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 7, datë 2.2.2015, i ndryshuar dhe veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 243, datë 2.12.2021.

2. Korrespondenca dhe dokumentacioni i depozituar nga shoqëria

- Shoqëria "Noa Energy Trade" sh.p.k., me shkresën nr. 826 prot., datë 5.3.2026, ka paraqitur pranë ERE-s kërkesën për krijimin e llogarisë në regjistrin elektronik të garancive të origjinës, në përputhje me nenin 6 të "Rregullores për lëshimin, transferimin, shlyerjen dhe anulimin e garancive të origjinës", miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 300, datë 30.12.2024.

- Shoqëria ka depozituar formularin e aplikimit të plotësuar sipas kërkesave të nenit 6, pika 4.1 të rregullores, duke specifikuar të dhënat identifikuese.

3. Analiza ligjore dhe vlerësimi

- Në përputhje me nenin 22, të ligjit nr. 24/2023, "Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme", ERE është organi kombëtar lëshues i garancive të origjinës dhe mban një regjistër elektronik për qëllime të lëshimit dhe administrimit të këtyre certifikatave.

- Vlerësohet se kërkesa përmbush të gjitha kriteret për hapjen e llogarisë në regjistrin elektronik të garancive të origjinës si furnizues/tregtar i energjisë elektrike.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Miratimin e kërkesës së shoqërisë "Noa Energy Trade" sh.p.k. për krijimin e llogarisë në regjistrin elektronik të garancive të origjinës.

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Garancisë së Origjinës të njoftojë shoqërinë "Noa Energy Trade" sh.p.k lidhur me vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes dijeni, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

VENDIM
Nr. 79, datë 12.3.2026

MBI MIRATIMIN E KËRKESËS SË SHOQËRISË "DEVOL HYDROPOWER" SHA PËR KRIJIMIN E LLOGARISË NË REGJISTRIN ELEKTRONIK TË GARANCIVE TË ORIGJINËS DHE REGJISTRIMIN FILLESTAR TË PAJISJEVE TË PRODHIMIT PËR HEC "MOGLICË" DHE HEC "BANJË"

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar; të nenit 22, të ligjit nr. 24/2023, "Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme"; të nenit 6, të "Rregullores për lëshimin, transferimin, shlyerjen dhe anulimin e garancive të origjinës për energjinë elektrike të prodhuar nga burimet e rinovueshme", miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 300, datë 30.12.2024; si dhe të nenit 15, të "Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s", miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 12.3.2026, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Garancisë së Origjinës, me nr. 660/1 prot., datë 11.3.2026, "Mbi shqyrtimin e kërkesës së shoqërisë 'Devol Hydropower' sh.a. për krijimin e llogarisë në regjistrin elektronik të garancive të origjinës dhe regjistrimin fillestar të pajisjeve të prodhimit për HEC 'Moglicë' dhe HEC 'Banjë'",

konstatoi se:

1. Të dhëna mbi shoqërinë "Devoll Hydropower" sh.a.

- Shoqëria "Devoll Hydropower" sh.a. është licencuar në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 80, datë 9.6.2016, nga HEC-et e kaskadës së lumit Devoll, përkatësisht për HEC "Moglicë" dhe HEC "Banjë". Gjithashtu, kjo shoqëri është licencuar në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 35, datë 4.3.2015, i ndryshuar dhe veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 36, datë 4.3.2015, të ndryshuar.

2. Korrespondenca dhe dokumentacioni i depozituar nga shoqëria

- Shoqëria "Devoll Hydropower" sh.a. me shkresën nr. 660 prot. datë 16.2.2026, ka paraqitur kërkesën për krijimin e llogarisë në regjistrin elektronik të garancive të origjinës dhe për regjistrimin fillestar të pajisjeve të prodhimit për HEC "Moglicë" dhe HEC "Banjë".

- Shoqëria ka bashkëlidhur formularin e aplikimit të plotësuar, sipas kërkesave të nenit 6 të rregullores, duke specifikuar të dhënat identifikuese dhe teknike të pajisjeve të prodhimit HEC-eve përfshirë karakteristikat teknike të secilit prej tyre, të dhënat mbi kapacitetin e instaluar, si dhe të pikës së matjes.

3. Analiza ligjore dhe vlerësimi

- Në përputhje me nenin 22, të ligjit nr. 24/2023, "Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme", ERE është organi kombëtar lëshues i garancive të origjinës dhe mban një regjistër elektronik për qëllime të lëshimit dhe administrimit të këtyre certifikatave.

- Në bazë të dokumentacionit të paraqitur, konstatohet se impiantet për të cilat kërkohet regjistrimi janë hidrocentrale me rezervuar, të cilët klasifikohen si impiante të përshtatshme për lëshimin e garancive të origjinës sipas nenit 6, të "Rregullores për lëshimin, transferimin, shlyerjen dhe anulimin e garancive të origjinës për energjinë elektrike të prodhuar nga burimet e rinovueshme".

- Gjithashtu, nga informacioni i paraqitur rezulton se këto impiante nuk janë të pajisura me sistem pompimi kthyes, dhe për rrjedhojë nuk përjashtohen nga përfitimi i garancive të origjinës, në përputhje me nenin 22, pika 7, të ligjit nr. 24/2023.

- Vlerësohet se kërkesa përmbush të gjitha kriteret për regjistrimin fillestar dhe hapjen e llogarisë në regjistër si prodhues i energjisë elektrike nga burime të rinovueshme.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Miratimin e kërkesës së shoqërisë "Devoll Hydropower" sh.a. për krijimin e llogarisë në regjistrin elektronik të garancive të origjinës dhe regjistrimin fillestar të pajisjeve të prodhimit për HEC "Moglicë" dhe HEC "Banjë".

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Garancisë së Origjinës të njoftojë shoqërinë "Devoll Hydropower" sh.a. lidhur me vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes dijeni, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

VENDIM
Nr. 80, datë 12.3.2026

MBI MIRATIMIN E KËRKESËS SË SHOQËRISË "NOVA SOLAR SYSTEM" SHPK PËR KRIJIMIN E LLOGARISË NË REGJISTRIN ELEKTRONIK TË GARANCIVE TË ORIGJINËS DHE REGJISTRIMIN FILLESTAR TË PAJISJEVE TË PRODHIMIT PËR CENTRALIN FOTOVOLTAIK

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar; të nenit 22, të ligjit nr. 24/2023, "Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme"; të nenit 6, të Rregullores për lëshimin, transferimin, shlyerjen dhe anulimin e garancive të origjinës për energjinë elektrike të prodhuar nga burimet e rinovueshme", miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 300, datë 30.12.2024; si dhe të nenit 15, të "Rregullores për

organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s", miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 12.3.2026, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Garancisë së Origjinës, me nr. 64/3 prot., datë 10.3.2026, "Mbi shqyrtimin e kërkesës së shoqërisë 'Nova Solar System' sh.p.k. për krijimin e llogarisë në regjistrin elektronik të garancive të origjinës dhe regjistrimin fillestar të pajisjeve të prodhimit për centralin fotovoltaik",

konstatoi se:

1. Të dhëna mbi shoqërinë "Nova Solar System" sh.p.k.

- Shoqëria "Nova Solar System" sh.p.k. është licencuar në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 242, datë 3.8.2023, të ndryshuar, për Centralin Fotovoltaik me kapacitet 50 mw, në zonën kadastrale nr. 3358, fshati Sheq-Marinas, Bashkia Fier, qarku Fier.

2. Korrespondenca dhe dokumentacioni i depozituar nga shoqëria

- Shoqëria "Nova Solar System" sh.p.k. me shkresën nr. 64/2 prot., datë 12.2.2026, ka paraqitur kërkesën për krijimin e llogarisë në regjistrin elektronik të garancive të origjinës.

- Nga analizimi i dokumentacionit/informacionit të përcjellë, u konstatuan mungesa, ndaj ERE me shkresën nr. 62/5 prot., datë 2.3.2026, i përcolli shoqërisë informacion mbi dokumentacionin që mungonte në këtë aplikim.

- Shoqëria me shkresën nr. 62/7 prot., datë 4.3.2026, ka përcjellë të plotë informacionin e kërkuar/munguar, referuar nenit 6 të rregullores.

- Shoqëria ka bashkëlidhur formularin e aplikimit të plotësuar, sipas kërkesave të nenit 6 të rregullores, duke specifikuar të dhënat identifikuese dhe teknike të pajisjeve të prodhimit, përfshirë karakteristikat teknike të centralit fotovoltaik, të dhënat mbi kapacitetin e instaluar, pikën e matjes, etj.

- Sa më sipër rezulton se më parë kjo shoqëri me shkresën nr. 64 prot., datë 8.1.2026 ka përcjellë "Kërkesë për pajisje me GO për impiantin fotovoltaik Nova Solar System", me specifikimet përkatëse, ku ndër të tjera kërkon lëshimin e Certifikatës së Garancisë së Origjinës për periudhën kohore 1.10.2024–31.12.2025. ERE, në përgjigje me shkresën nr. 64/1 prot., datë 29.1.2026, i ka bërë me dije shoqërisë se në zbatim të nenit 6, të "Rregullores për lëshimin, transferimin, shlyerjen dhe anulimin e garancive të origjinës për energjinë elektrike të prodhuar nga burimet e rinovueshme", miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 300, datë 30.12.2024, se shoqëria duhet të paraqesë në fillim kërkesën për krijimin e një llogarie në regjistrin elektronik të garancive të origjinës, së bashku me të dhënat e përcaktuara në pikën 4 të këtij neni.

3. Analiza ligjore dhe vlerësimi

- Në përputhje me nenin 22, të ligjit nr. 24/2023, "Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme", ERE është organi kombëtar lëshues i garancive të origjinës dhe mban një regjistër elektronik për qëllime të lëshimit dhe administrimit të këtyre certifikatave.

- Në bazë të dokumentacionit të paraqitur, konstatohet se centrali fotovoltaik për të cilin kërkohet regjistrimi klasifikohet i përshtatshëm për lëshimin e garancive të origjinës sipas nenit 6 të rregullores dhe tabelës 1.1 të saj.

- Vlerësohet se kërkesa përmbush të gjitha kriteret për regjistrimin fillestar dhe hapjen e llogarisë në regjistër si prodhues i energjisë elektrike nga burime të rinovueshme.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Miratimin e kërkesës së shoqërisë "Nova Solar System" sh.p.k. për krijimin e llogarisë në regjistrin elektronik të garancive të origjinës dhe regjistrimin fillestar të pajisjeve të prodhimit për centralin fotovoltaik.

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Garancisë së Origjinës të njoftojë shoqërinë "Nova Solar System" sh.p.k. lidhur me vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes dijeni, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

VENDIM
Nr. 81, datë 12.3.2026

MBI MIRATIMIN E DISA NDRYSHIMEVE NË "RREGULLOREN PËR CILËSINË E FURNIZIMIT DHE PERFORMANCËN E SIGURISË SË RRJETIT NË SISTEMIN E TRANSMETIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE", MIRATUAR ME VENDIMIN E BORDIT TË ERE-s NR. 207, DATË 18.12.2017 DHE NË TREGUESIT E KRITEREVE STANDARDE TË CILËSISË SË SHËRBIMIT NË SISTEMIN E TRANSMETIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE

Në zbatim të neneve 7, pika 1, 10 pika 2, 16, 19, germa "h" dhe "j", 20, germa "a" dhe 27, pika 3, të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar, si dhe të neneve 15 dhe 26, të "Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s", miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 12.3.2026, pasi shqyrtoi relacionin me nr. 82/1 prot., datë 10.3.2026, të përgatitur nga Drejtoria e Monitorimit të Tregut dhe Zhvillimit të Burimeve të Rinovueshme, Drejtoria e Çështjeve Konsumatore dhe Zgjidhjes Alternative të Ankesave dhe Drejtoria e Monitorimit të Standardeve të Cilësisë, Sigurisë së Sistemit dhe Detyrimeve të Shërbimit Publik, "Mbi miratimin e disa ndryshimeve në 'Rregulloren për cilësinë e furnizimit dhe performancën e sigurisë së rrjetit në sistemin e transmetimit të energjisë elektrike"', miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 207, datë 18.2.2017 dhe në treguesit e kritereve standarde të cilësisë së shërbimit në sistemin e transmetimit të energjisë elektrike",

konstatoi se:

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 300, datë 17.11.2025, vendosi "Mbi fillimin e procedurës për disa ndryshime në 'Rregulloren për cilësinë e furnizimit dhe performancën e sigurisë së rrjetit në sistemin e transmetimit të energjisë elektrike"', miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 207, datë 18.12.2017 dhe në treguesit e kritereve standarde të cilësisë së shërbimit në sistemin e transmetimit të energjisë elektrike".

- ERE, me shkresën nr. 2865/1 prot., datë 21.11.2025, njoftoi palët e interesuara Operatorin e Sistemit të Transmetimit (OST) sh.a., Shoqatën Shqiptare të Furnizuesve të Energjisë Elektrike (AAES), Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE), Ministrinë e Ekonomisë dhe Inovacionit (MEI), Shoqatën e Mbrojtjes së Konsumatorit (MK), Agjencinë e Mbrojtjes së Konsumatorit (AMK), Dhomën e Tregtisë dhe Industrisë (DHTI), Autoritetin e Konkurrencës (AK), Avokatin e Popullit (AP), Shoqatën Konsumatori në Fokus (KF), mbi vendimin nr. 300/2025 për të shprehur opinionet/komentet për ndryshimet në "Rregulloren për cilësinë e furnizimit dhe performancën e sigurisë së rrjetit të transmetimit të energjisë elektrike".

- Gjithashtu, me shkresën nr. 82 prot., datë 9.1.2026, ERE njoftoi Shoqatën e Investitorëve të Huaj në Shqipëri (FIAA) dhe Shoqatën Shqiptare të Energjisë së Rinovueshme (AREA) mbi marrjen e vendimit nr. 300, datë 17.11.2025, nga Bordi i ERE-s.

- Pas përfundimit të afatit 20-ditor të marrjes së mendimeve nga palët e interesuara, rezultoi se janë paraqitur në ERE mendime nga Shoqata Shqiptare e Furnizuesve të Energjisë Elektrike me nr. 3087 prot., datë 17.12.2025 dhe 196/4 prot., datë 21.1.2026, Ministria e Ekonomisë dhe Inovacionit, si dhe Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë. Në vijim, u konstatua se komentet e AAES janë përcjellë gabimisht, në lidhje me rregulloren e sipërcituar, për të cilën edhe vetë Shoqata AAES ka bërë me dije në ERE.

- Ministria e Ekonomisë dhe Inovacionit, me shkresën nr. 2865/2 prot., datë 12.12.2025, si dhe Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, me shkresën nr. 2865/4 prot., datë 24.12.2025, janë shprehur parimisht dakord brenda fushës së përgjegjësisë së tyre, lidhur me vendimin nr. 307/2025, "Mbi fillimin e procedurës për disa ndryshime në 'Rregulloren për cilësinë e furnizimit dhe performancën e sigurisë së rrjetit në sistemin e transmetimit të energjisë elektrike', miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 207, datë 18.12.2017 dhe në treguesit e kritereve standarde të cilësisë së shërbimit në sistemin e transmetimit të energjisë elektrike".

- ERE, më datë 27.1.2026, organizoi seancën dëgjimore, në të cilën morën pjesë përfaqësues të OST sh.a., AAES, të shoqërisë SPV Blue 1 sh.p.k., të Avokatit të Popullit, si dhe përfaqësues të ERE-s, me qëllim diskutimin mbi komentet e palëve të interesit në lidhje me ndryshimet për të cilat ka filluar procedura me vendimin nr. 307/2025.

- Të gjithë pjesëmarrësit në këtë seancë u shprehën dakord me çdo pikë të ndryshimeve të propozuara dhe i sugjeruan ERE-s vijimin e procedurës për miratimin e këtyre ndryshimeve në rregullore, me qëllim përmirësimin e cilësisë së furnizimit në sistemin e transmetimit të energjisë elektrike.

- Treguesit e performancës AIT (Koha mesatare e ndërprerjes), ENS (Energjia e pafurnizuar) dhe SAIDI (Indeksi i kohëzgjatjes mesatare të ndërprerjeve), për të cilët ka filluar procedura me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 300, datë 17.11.2025, për efekt praktik janë rrumbullakosur si vijon: nga 25.96 minuta në 26 minuta për AIT, nga 365.997 mwh në 366 mwh për ENS dhe nga 39.48 minuta në 39.5 minuta për SAIDI.

- Neni 12, i "Rregullores për cilësinë e furnizimit dhe performancën e sigurisë së rrjetit në sistemin e transmetimit të energjisë elektrike", parashikon se: "Kjo rregullore është objekt rishikimi ose ndryshimi me vendim të Bordit të ERE-s".

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Miratimin e disa ndryshimeve në aneksin e "Rregullores për cilësinë e furnizimit dhe performancën e sigurisë së rrjetit në sistemin e transmetimit të energjisë elektrike", miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 207, datë 18.12.2017, miratuar me vendimin nr. 244, datë 02.12.2021, sipas tabelës së standardeve të cilësisë:

- AIT (Koha mesatare e ndërprerjes) ishte 35 min. – bëhet 26 min.;

- ENS (Energji e pafurnizuar) ishte 467 mwh - bëhet 366 mwh,;

- SAIDI (Indeksi i Kohëzgjatjes Mesatare të Ndërprerjeve) ishte 100 min. – bëhet 39.5 min.;

- VQ (Cilësia e Tensionit) ishte brenda diapazonit: -10%, +11.8 – bëhet brenda diapazonit (110 kV- 300 kV): 0.90 pu - 1.118 pu; dhe brenda diapazonit (300 kV – 400 kV): 0,90 pu – 1,05 pu.

- Neni 6, i "Rregullores për cilësinë e furnizimit dhe performancën e sigurisë së rrjetit në sistemin e transmetimit të energjisë elektrike", miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 207, datë 18.12.2017, shfuqizohet;

- Paragrafi i fundit, i pikës 7.1, të nenit 7, të "Rregullores për cilësinë e furnizimit dhe performancën e sigurisë së rrjetit në sistemin e transmetimit të energjisë elektrike", miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 207, datë 18.12.2017, ndryshon dhe bëhet: "Nivelet e pritshme të performancës, siç miratuar nga ERE, do të vihen në zbatim menjëherë dhe do të mbeten në fuqi, deri në rivlerësimin e këtyre standardeve nga ERE në funksion të performancës së realizuar.";

- Pika 7.2, e nenit 7, të "Rregullores për cilësinë e furnizimit dhe performancën e sigurisë së rrjetit në sistemin e transmetimit të energjisë elektrike", miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 207, datë 18.12.2017, shfuqizohet;

- Pika 7.3, nenit 7 të "Rregullores për cilësinë e furnizimit dhe performancën e sigurisë së rrjetit në sistemin e transmetimit të energjisë elektrike", miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 207, datë 18.12.2017, ndryshon dhe bëhet: "OST sh.a. do të propozojë për shqyrtim dhe miratim në ERE nivelin e lejuar të rishikuar të kritereve standardeve të cilësisë së shërbimit në funksion të performancës së realizuar. ERE në çdo kohë, me iniciativën e saj mund të nis procesin e shqyrtimit dhe miratimit të standardeve të cilësisë së shërbimit në funksion të performancës së matur, raportuar dhe ushtruar".

- Pika 7.4, nenit 7, të "Rregullores për cilësinë e furnizimit dhe performancën e sigurisë së rrjetit në sistemin e transmetimit të energjisë elektrike", miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 207, datë 18.12.2017, ndryshon dhe bëhet: "Jo më vonë se njëherë në 3 vjet, ERE do të rishqyrtojë performancën e arritur gjatë kësaj periudhe, do të rivlerësojë nivelet e pritshme të performancës dhe do të miratojë nivelin e lejuar të kritereve standarde të cilësisë së furnizimit dhe performancës së sigurisë së rrjetit në sistemin e transmetimit.";

- Pika 9.1, e nenit 9 të "Rregullores për cilësinë e furnizimit dhe performancën e sigurisë së rrjetit në sistemin e transmetimit të energjisë elektrike", miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 207, datë 18.12.2017, ndryshon dhe bëhet: "Kompensimi i klientëve fundor të lidhur në rrjetin e transmetimit, në rast të mosrespektimit të kritereve standarde të

cilësisë së furnizimit dhe performancës së sigurisë së rrjetit në sistemin e transmetimit të energjisë elektrike sipas përcaktimeve të kësaj rregulloreje, do të bëhet bazuar në përcaktimet e Kodit të Rrjetit të Transmetimit dhe Marrëveshjes së Shërbimit të Transmetimit.".

2. Drejtoria Çështjeve Konsumatore dhe Zgjidhjes Alternative të Ankesave të njoftojë shoqërinë OST sh.a. dhe palët e interesit për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes dijeni, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

VENDIM
Nr. 82, datë 19.3.2026

MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR SHQYRTIMIN E KËRKESËS SË SHOQËRISË "HYDROSOLAR ENERGY (HSE)" SHPK PËR LICENCIM NË VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të neneve 16 dhe 37, pika 2, germa "a", të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar; të neneve 4, pika 1, germa "a", 5, pika 1, germa "a", dhe 10, pikat 1 dhe 3, të "Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike", të miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.6.2016, të ndryshuar; si dhe të neneve 15 dhe 19, pika 1, germa "a" të "Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s", miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 19.3.2026, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 828/1 prot., datë 18.3.2026, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Garancisë së Origjinës "Mbi kërkesën e shoqërisë 'Hydrosolar Energy (HSE)' sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike",

konstatoi se:

- Shoqëria "Hydrosolar Energy (HSE)" sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 828 prot., datë 5.3.2026, ka paraqitur kërkesën e saj për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik, me kapacitet të instaluar 2 mw, me vendndodhje në fshatin Povelçë, Njësia Administrative Dërmenas, Bashkia Fier, qarku Fier.

- Nga shqyrtimi i aplikimit, në referencë të përcaktimeve të "Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar, rezulton se:

Përputhshmëria e aplikimit me rregulloren

- Në përputhje me nenin 9, për pikat 1 dhe 1.1 të rregullores, aplikuesi ka dorëzuar dokumentacionin e kërkuar për pajisjen me licencë sipas germave "a", "b" dhe "c", duke plotësuar formularin sipas formatit të përcaktuar në shtojcën 1;

- Në përputhje me nenin 9, për pikën 1.2, të rregullores, aplikuesi ka dorëzuar dokumentacionin juridik dhe administrativ të kërkuar sipas germave "a" dhe "d";

- Në përputhje me nenin 9, për pikën 1.3 të rregullores, aplikuesi ka dorëzuar dokumentacionin financiar dhe fiskal të kërkuar sipas germave "a" dhe ""c".

- Në përputhje me nenin 9, pikën 2 të rregullores, aplikuesi ka dorëzuar dokumentacionin specifik për licencimin në sektorin e prodhimit të energjisë elektrike sipas germave "b", "c" dhe "d".

Pajisja e shoqërisë me leje dhe miratime të tjera

Rezulton se shoqëria "Hydrosolar Energy (HSE)" sh.p.k.:

- ka nënshkruar me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE) kontratën nr. 188 rep., nr. 413 kol., datë 10.2.2026, "Për ndërtimin, shfrytëzimin dhe administrimin e centralit gjenerues të energjisë elektrike fotovoltaike, me kapacitet prodhues 2 mw dhe veprave ndihmëse, me vendndodhje në fshatin Povelçë, Njësia Administrative Dërmenas, Bashkia

Fier, qarku Fier, nga shoqëria 'Hydrosolar Energy' sh.p.k.";

- Është pajisur me miratimin për pikën e lidhjes së centralit me rrjetin e shpërndarjes nëpërmjet shkresës së OSSH sh.a. nr. 3381/3 prot., datë 4.7.2025;

- Është pajisur me Vendim VNM Paraprake, lëshuar më 9.7.2025, nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit (AKM), për zhvillimin e projektit "Impiantit Fotovoltaik", me kapacitet 2 mw.

Në këtë aplikim duhet të plotësohet dhe sa vijon:

NENI 9

Formati dhe dokumentacioni për aplikim

Pika 1, Dokumentacioni i përgjithshëm për të gjitha aplikimet për pajisje me licencë

Pika 1.2, Dokumentacioni juridik dhe administrativ

- germa "b": aplikuesi duhet të depozitojë në ERE dëshminë e penalitetit të lëshuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve, për vetë shoqërinë;

- germa "c": aplikuesi duhet të japë sqarimet përkatëse në lidhje me stafin teknik efektiv.

Pika 1.3. Dokumentacioni financiar dhe fiskal

- germa "b": shoqëria duhet të depozitojë dokumentacion të përditësuar në lidhje me mbështetjen financiare;

Pika 2, Dokumentacioni specifik sipas tipit të licencës

Pika 2.1 Për t'u pajisur me licencë për prodhimin e energjisë elektrike, aplikuesi duhet të depozitojë gjithashtu:

- germa "a": shoqëria duhet të saktësojë jetëgjatësinë e pritshme të centralit dhe të përcaktojë datë konkrete kur parashikon të fillojë operimi i centralit, si dhe të depozitojë një garanci për panelet që do të përdorë, në rast se ka;

- germa "e": Rezulton se shoqëria disponon një VNM të vlefshme deri më 9.7.2027, por duke qenë se në shtojcën 2 ka deklaruar se viti i ndërtimit është viti 2026 dhe vetë nuk ka paraqitur ndonjë informacion në lidhje me fillimin e punimeve për ndërtimin e centralit, vlerësohet që t'i kërkohet shoqërisë ky informacion në vijim. Po ashtu, vlerësohet t'i kërkohet të bëjë saktësimin përkatës të koordinatave, në lidhje me vendndodhjen e projektit, në referencë të kontratës me MIE-n.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë "Hydrosolar Energy (HSE)" sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik, me kapacitet të instaluar 2 mw, me vendndodhje në fshatin Povelçë, Njësia Administrative Dërmenas, Bashkia Fier, qarku Fier.

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Garancisë së Origjinës të njoftojë shoqërinë "Hydrosolar Energy (HSE)" sh.p.k. dhe Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes dijeni të vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

VENDIM
Nr. 83, datë 19.3.2026

MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR SHQYRTIMIN E KËRKESËS SË SHOQËRISË "SUNNY SIDE ENERGY" SHPK PËR LICENCIM NË VEPRIMTARINË E FURNIZIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të neneve 16 dhe 37, pika 2, germa "ç", të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar; të neneve 4, pika 1, germa "d", 5, pika 1, germa "d", dhe 10, pikat 1 dhe 3, të "Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike", të miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.6.2016, të ndryshuar; si dhe të neneve 15 dhe 19, pika 1, germa "a", të "Rregullores për

organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s", miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 19.3.2026, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 856/2 prot., datë 18.3.2026, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Garancisë së Origjinës "Mbi kërkesën e shoqërisë 'Sunny Side Energy' sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike",

konstatoi se:

- Shoqëria "Sunny Side Energy" sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 856 prot., datë 9.3.2026, ka paraqitur kërkesën e saj për licencim në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike.

- Nga shqyrtimi i aplikimit, në referencë të përcaktimeve të "Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar, rezulton se shoqëria ka kryer pagesën e aplikimit sipas përcaktimeve të aneksit A dhe ka plotësuar dokumentacionin e kërkuar në pikën 1.1, për germat: "a", "b" dhe "c"; në pikën 1.2, për germat "a" dhe "d"; në pikën 1.3, për germën "a"; në pikën 2.4, për germat: "a", "b" dhe "d".

Shoqëria duhet të plotësojë më tej informacionin/dokumentacionin si vijon:

Neni 9. Formati dhe dokumentacioni për aplikim

Pika 1. Dokumentacioni i përgjithshëm për të gjitha aplikimet për pajisje me licencë

Pika 1.2. Dokumentacioni juridik dhe administrativ

- germa "b": shoqëria duhet të depozitojë dëshminë e penalitetit të lëshuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve, për administratorin dhe vetë shoqërinë;

- germa "c": shoqëria ka depozituar strukturën e saj organizative në gjuhën angleze. Në referencë të përcaktimeve të nenit 8, pika 3, të rregullores, ky dokument duhet të depozitohet në gjuhën shqipe.

Pika 1.3. Dokumentacioni financiar dhe fiskal

- germa "b": shoqëria duhet të dokumentojë mbështetjen financiare për të garantuar ushtrimin e të paktën 1 (një) muaji të veprimtarisë së furnizimit të energjisë elektrike, në përputhje me përcaktimet e rregullores dhe të vendimit të Bordit të ERE-s nr. 16, datë 16.1.2025, duke bazuar përllogaritjen për mbështetjen financiare që i nevojitet për të garantuar ushtrimin e të paktën 1 muaji të veprimtarisë në sasinë e energjisë së parashikuar dhe çmimin mujor të Ditës në Avancë të Bursës Shqiptare të Energjisë Elektrike (ALPEX) për muajin që i paraprin datës së aplikimit;

- germa "c": shoqëria duhet të përditësojë planin e biznesit duke reflektuar mënyrën e financimit të ushtrimit të veprimtarisë së furnizimit të energjisë elektrike, si dhe dokumentacion provues përkatës. Dokumenti i përditësuar duhet të depozitohet në ERE.

Pika 2.4. Dokumentacioni specifik për licencën e furnizimit të energjisë elektrike

- germa "c": shoqëria duhet të japë informacion mbi disponimin e zyrave përfaqësuese të furnizuesit për të 5 vitet e vlefshmërisë së licencës.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë "Sunny Side Energy" sh.p.k. në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike, për një afat 5-vjeçar.

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Garancisë së Origjinës të njoftojë shoqërinë për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

VENDIM
Nr. 84, datë 19.3.2026

MBI DHËNIEN E AUTORIZIMIT NGA ERE PËR VENDOSJEN E KUOTAVE TË SHOQËRISË "SA-GLE KOMPANI" SHPK SI MJET PËR GARANTIMIN E DETYRIMIT NDAJ TË TRETËVE

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar; të neneve 9, pika 8, dhe 10, të "Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien e autorizimit nga ERE për ndryshimin e statusit ligjor të të licencuarit, ndryshimin e ortakut/aksionarit që kontrollon interesat e të licencuarit dhe vendosjen e kuotave/aksioneve të ortakut/aksionerit që kontrollon interesat e të licencuarit si mjete për garantimin e përmbushjes së detyrimit/eve ndaj të tretëve", miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 235, datë 26.11.2021; si dhe nenit 15, të "Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s", miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 19.3.2026, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 316/11 prot., datë 18.3.2026, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Garancisë së Origjinës , "Mbi kërkesën e shoqërisë 'SA-GLE Kompani' sh.p.k. për dhënien e autorizimit nga ERE për vendosjen e kuotave të saj, si mjet për garantimin e përmbushjes së detyrimit ndaj 'First Investment Bank-Albania" sh.a."',

konstatoi se:

Për qëllime të shqyrtimit të kërkesës për dhënien e autorizimit për shoqërinë "SA-GLE Kompani" sh.p.k., është ndjekur procedura dhe është analizuar dokumentacioni si vijon:

1. Kërkesa për marrjen e autorizimit

- Shoqëria "SA-GLE Kompani" sh.p.k., është licencuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 123, datë 29.8.2012, në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike.

- Me shkresën nr. 316 prot., datë 23.1.2026, shoqëria ka paraqitur aplikim/dokumentacion për marrjen e autorizimit nga ERE për vendosjen e kuotave të saj si mjet për të garantuar përmbushjen e detyrimit ndaj palës kredidhënëse "First Investment Bank-Albania" sh.a.

2. Shqyrtimi i kërkesës dhe kërkesa për dokumentacion plotësues

- ERE nëpërmjet shkresës nr. 316/2 prot., datë 5.2.2026 dhe *email*-it datë 5.2.2026, ka njoftuar shoqërinë dhe bankën për zhvillimin e një seance dëgjimore në datë 12.2.2026, duke i evidentuar gjithashtu depozitimin e informacionit/ dokumentacionit të konstatuar të munguar në këtë aplikim.

- Në vijim, ERE i dërgoi shoqërisë dhe bankës shkresën nr. 316/8 prot., datë 18.2.2026, si dhe nisi *email*-et rikujtesë në datat 20.2.2026 dhe 6.3.2026, ku i risolli në vëmendje si bankës ashtu dhe shoqërisë se duhet të përcjellë deklaratën përkatëse nga banka financuese.

- Shoqëria/banka me shkresat nr. 316/5 prot., datë 12.2.2026, nr. 316/6 prot., datë 17.2.2026 dhe nr. 316/10 prot., datë 12.3.2026, ka depozituar të plotë dokumentacionin e kërkuar.

3. Përfundime dhe kërkesa të tjera për dhënien e autorizimit

- Nga analiza e dokumentacionit të përcjellë nga shoqëria "SA-GLE Kompani" sh.p.k., rezulton se është dorëzuar dokumentacioni në përputhje me kërkesat e parashikuara në nenet 5, 6, 7 dhe 8, të "Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien e autorizimit nga ERE për ndryshimin e statusit ligjor të të licencuarit, ndryshimin e ortakut/ aksionarit që kontrollon interesat e të licencuarit dhe vendosjen e kuotave/aksioneve të ortakut/ aksionerit që kontrollon interesat e të licencuarit si mjete për garantimin e përmbushjes së detyrimit/ eve ndaj të tretëve", miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 235, datë 26.11.2021, si vijon:

- Neni 5, pika 2 – Kërkesa dhe dokumentet shoqëruese janë nënshkruar nga administratori i shoqërisë, në përputhje me kërkesat e rregullores.

4. Plotësimi i kërkesave të nenit 5:

- Neni 5, pika 4 – Dokumentacioni është paraqitur në gjuhën shqipe, në format origjinal ose fotokopjoje të noterizuar dhe i shoqëruar me kopje elektronike.

- Neni 5, pika 5 – Shoqëria kërkon që të mbahet konfidencial informacioni, lidhur me kontratën e kredisë/akteve pas vijuese të saj dhe çdo informacion tjetër financiar/tregtar që gjendet në dokumentacionin e vënë në dispozicion, duke qenë së përbëjnë të dhëna financiare-tregtare/ konfidenciale të shoqërive, si dhe të dhëna personale sensitive të nënshkruesve të akteve, të cilat nuk

përbëjnë interes parësor dhe thelbësor për palë të treta, përveç institucioneve të përfshira në këtë proces shqyrtimi.

Për sa kërkuar nga shoqëria, në lidhje me trajtimin me konfidencialitet të dosjes së aplikimit, është bërë trajtimi i dokumentacionit në zbatim të ligjit nr. 9887, datë 10.3.2008, "Për mbrojtjen e të dhënave personale", të ndryshuar, dhe "Rregullores për mbrojtjen e informacionit konfidencial", miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 65, datë 26.3.2018, ku është klasifikuar dokumentacioni i cili konsiston në trajtim tërësisht konfidencial apo dokumentacion i cili ka identifikimet përkatëse si konfidenciale, duke zbatuar parimin e kufizimit proporcional (pra, klasifikim vetëm për ato pjesë ku ka bazë ligjore dhe nevojë reale për mbrojtje).

Nga analizimi i dokumentacionit të depozituar, duke qenë se përmbajnë të dhëna identifikuese të personave fizikë, si dhe informacione të aktivitetit tregtar, justifikojnë trajtimin si konfidencial, dokumentacioni si vijon:

- Shkresa e shoqërisë "SA-GLE Kompani" sh.p.k., datë 21.1.2026, me lëndë: "Kërkesë për dhënien e autorizimit nga ERE për vendosjen e kuotave të të licencuarit si mjet për garantimin e detyrimit ndaj të tretëve" dhe shkresa e datës 12.2.2026 me lëndë: "Vënie në dispozicion dokumentacioni" (do të konsiderohen konfidenciale vetëm të dhënat personale të administratorit, si dhe informacione të aktivitetit tregtar të shoqërisë).

- Fotokopje e noterizuar e regjistrit të Barrëve Siguruese (ky dokument do të konsiderohet si konfidencial, duke qenë se përmban të dhëna sensitive të shoqërisë, si dhe informacione mbi aktivitetin tregtar të shoqërisë).

- Autorizimi i datës 12.2.2026, për znj. N. B. për të marrë pjesë në seancën dëgjimore të zhvilluar. (ky dokument do të konsiderohet konfidencial, në lidhje me të dhënat identifikuese të tilla si emër, mbiemër, nr. i ID, adresën e banimit, datëlindjen dhe nr. personal).

- Kontratë kredie bankare nr. 3185 rep., nr. 1138 kol., datë 19.9.2022 (ky dokument do të konsiderohet si konfidencial, duke qenë se përmban termat e një marrëdhënieje garancie dhe përfshin: kushte financimi, detaje të kontratave të kredisë, risk kreditor, klauzola sigurimi, detyrime të palëve, të cilat janë të dhëna me natyrë ekonomike/ kontraktuale që mund të dëmtojnë interesat e subjektit/palëve të treta nëse publikohen).

- Kontrata e koncesionit nr. 2901 rep., nr. 395 kol., datë 14.9.2009, e nënshkruar ndërmjet shoqërisë dhe MIE-s (ky dokument do të konsiderohet si konfidencial, duke qenë se përmban informacione të konsideruara si sekrete tregtare, të tilla si: plane financiare, modele biznesi, kosto operative, strategji investimi, të cilat mbrohen nga ligji, si dhe për të ruajtur interesin ekonomik të shoqërisë).

- Nga ana tjetër, do të konsiderohet dhe trajtohet si jokonfidencial, për arsye se janë dokumente me karakter deklarativ/informues dhe/ose është e depozituar apo e aksesueshme pranë institucioneve publike kompetente, dokumentacioni si vijon:

- Ekstrakti i regjistrit tregtar i shoqërisë SA-GLE Kompani sh.p.k. (ky dokument do të konsiderohen si jokonfidencial, në rrethanat që janë të publikuara dhe të aksesueshme pranë institucioneve publike kompetente, në rastin konkret QKB-ja);

- Marrëveshje siguruese (marrëveshje kolaterali financiar) nr. 3187 rep., nr. 1140 kol., datë 19.9.2022, mbi barrësimin e 100% të kuotave të shoqërisë dhe marrëveshje siguruese nr. 3186 rep., nr. 1139 kol., datë 19.9.2022, mbi vendosjen 100% të kuotave (marrëveshjet siguruese të sipërpërmendura do të konsiderohen jokonfidenciale, por me redaktim selektiv të elementeve që kanë të dhëna financiare sensitive dhe të dhëna personale).

- Kontratë shitje pasuri e luajtshme me nr. 9473 rep., nr. 3091 kol., datë 9.11.2021 (ky dokument do të konsiderohet si jokonfidencial, por me redaktim selektiv, për arsye se konsiderohet si një dokument me natyrë juridike deklarative dhe lidhet me ndryshimin e pronësisë së kuotave, informacion i cili reflektohet dhe në regjistrin tregtar).

- Vendimi i datës 19.9.2022, i Ortakut të Vetëm të shoqërisë SA-GLE Kompani sh.p.k. AG Hpower & Construction sh.p.k.; vendimi i datës 19.9.2022 i Ortakut të Vetëm të shoqërisë "AG Hpower & Construction" sh.p.k.; vendimi nr. 28, datë 25.10.2021, i Ortakëve të Shoqërisë "ENRIKU" sh.p.k.; vendimi nr. 7, 25.10.2021, i Ortakëve të shoqërisë "AG Hpower & Construction" sh.p.k.; vendimi nr. 12, datë 25.10.2021, i Ortakëve të shoqërisë Koncesionare "SA-GLE Kompani" sh.p.k., (këto dokumente do të konsiderohen jokonfidenciale, por me redaktim selektiv të elementeve që kanë të dhëna financiare sensitive dhe të dhëna personale).

- Deklarata e administratorit e datës 21.1.2026,

mbi kuotat e shoqërisë që nuk janë barrësuar dhe deklarata e administratorit e datës 12.2.2026, mbi vullnetin për të zbatuar çdo akt ligjor në fuqi (këto dokumente përbëjnë akte të brendshme deklarative, që lidhen me organizimin dhe vendimmarrjen e shoqërisë. Ato nuk përmbajnë në vetvete sekret tregtar apo informacion financiar të ndjeshëm, ndaj konsiderohen dokumente me natyrë jokonfidenciale, por me redaktim selektiv të elementeve që kanë të dhëna financiare dhe personale).

- Deklarata e lëshuar nga banka e datës 11.3.2026, mbi gatishmërinë e vullnetin për të zbatuar çdo akt ligjor në fuqi (ky dokument do të konsiderohet si jokonfidencial, por me redaktim selektiv të elementeve që kanë të dhëna financiare sensitive dhe të dhëna personale).

- Shkresa e MIE-s nr. 7466/2 prot., datë 24.12.2021, me lëndë: "Miratohet transferimi i kapitalit të shoqërisë koncesionare "SA-GLE Kompani" sh.p.k., si dhe shkresa drejtuar MIE-s me nr. 299 prot., datë 14.12.2011, ku njofton për fazën e miratimit të kredisë (këto dokumente do të konsiderohen si jokonfidenciale, duke qenë se nuk përmbajnë të dhëna personale apo të aktivitetit tregtar që mund të dëmtojnë shoqërinë në rast publikimi).

5. Plotësimi i kërkesës sipas nenit 8:

- pika 1 – Janë paraqitur të gjitha të dhënat e kërkuara mbi shoqërinë, arsyet për vendosjen e barrës siguruese, përshkrimi i detyrimeve dhe deklarata mbi statusin e kuotave;

- pika 2 – Janë dorëzuar të gjitha dokumentet përkatëse, përfshirë ekstraktin historik të regjistrit tregtar, vendimet e organeve drejtuese, marrëveshjen përkatëse dhe dokumentacionin tjetër shtetëror si më poshtë vijon:

- germa "a" - ekstrakti historik i regjistrit tregtar;

- germa "b" - vendimi i organeve drejtuese: Është depozituar vendimi i Ortakut të Vetëm të shoqërisë "SA-GLE Kompani" sh.p.k., nr. 3183, datë 19.9.2022, me anë të së cilës është shprehur dakordësia mbi vendosjen e 100% të kuotave të kësaj shoqërie si garanci për shlyerjen e detyrimit ndaj "Banka e Parë e Investimeve-Albania" sh.a.;

- germa "c" – marrëveshjet përkatëse:

- "Kontratën e kredisë" nr. 3185 rep., nr. 1138 kol., datë 19.9.2022, nënshkruar midis palëve, ku qëllimi i përdorimit të kredisë është: Përmbushja e detyrimeve të kredisë që kredimarrësi ka pranë "Credins Bank" sh.a., që është përdorur për investime në HPP;

- Pika 3 – shoqëria ka shlyer të gjitha detyrimet financiare ndaj ERE-s.

6. Kushtet e vendosura për dhënien e autorizimit

- Dhënia e autorizimit nga ERE për vendosjen e kuotave të shoqërisë "SA-GLE Kompani" sh.p.k., si mjet për garantimin e detyrimit ndaj të tretëve, nuk e përjashton këtë të fundit nga detyrimi për të marrë autorizimet ose miratimet e nevojshme nga organet e tjera kompetente apo nga palët e treta përkatëse, në rast se kjo kërkohet nga kuadri ligjor ose nga marrëveshjet kontraktuale në fuqi.

Vendosja e këtij kushti bëhet për të garantuar se autorizimi i dhënë nga ERE mbetet i kufizuar vetëm në kuadër të ushtrimit të funksioneve të saj rregullatore, pa ndërhyrë apo anashkaluar detyrimet ligjore ose kontraktuale që mund të ketë shoqëria ndaj autoriteteve të tjera ose palëve të përfshira në marrëdhënie financiare apo tregtare. Në këtë rast, duke qenë se marrëveshja është nënshkruar me bankë vendase, është përgjegjësi e shoqërisë të respektojë çdo detyrim tjetër jashtë kompetencës së ERE-s që mund të rrjedhë nga këto marrëveshje.

- Në referencë të nenit 9, pika 8 të rregullores, ku citohet se shoqëria duhet të depozitojë në ERE ekstraktin historik të regjistrit tregtar, ku të reflektohet ndryshimi vendosja e kolateralit mbi kuotat e saj, vlen të sqarojmë se shoqëria e ka një veprim tashmë të ezauruar/pasqyruar, si e tillë nuk lind e nevojshme të mbahet në konsideratë në vijim, gjithmonë në rastin e dhënies së autorizimit nga ERE.

- Shoqëria detyrohet të njoftojë ERE-n në rast të heqjes së barrës siguruese ose të ekzekutimit të saj të detyrueshëm.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Dhënien e autorizimit të ERE-s për vendosjen e kuotave të shoqërisë "SA-GLE Kompani" sh.p.k. si mjet për të garantuar përmbushjen e detyrimit ndaj palës kredidhënëse "First Investment Bank-Albania" sh.a. (sipas kontratës së kredisë nr. 3185 rep., nr. 1138 kol., datë 19.9.2022).

2. Dhënia e autorizimit nga ERE sipas përcaktimeve të pikës 1 të këtij vendimi nuk e çliron shoqërinë "SA-GLE Kompani" sh.p.k. nga detyrimi për të marrë autorizimin/miratimin e organeve të

tjera apo palëve të treta për këtë ndryshim, në rast se kjo kërkohet nga këto organe.

3. Shoqëria "SA-GLE Kompani" sh.p.k. të njoftojë ERE-n për heqjen e barrës siguruese mbi kuotat ose në rast të ndodhjes së një ekzekutimi të detyrueshëm.

4. Ky vendim është objekt rishikimi nga ERE, në zbatim të pikave 2 dhe 3, si dhe në rast se nga MIE depozitohet një qëndrim ndryshe, në lidhje me detyrimet që i burojnë shoqërisë nga kontrata e nënshkruar datë 14.9.2009, apo në rast të depozitimit të dokumentacionit të ndryshëm nga ai që i ka shërbyer kësaj vendimmarrje.

5. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Garancisë së Origjinës të njoftojë shoqërinë "SA-GLE Kompani" sh.p.k. për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes dijeni të vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

VENDIM
Nr. 85, datë 19.3.2026

MBI MIRATIMIN E KËRKESËS SË SHOQËRISË "ENER TRADE" SHPK PËR KRIJIMIN E LLOGARISË NË REGJISTRIN ELEKTRONIK TË GARANCIVE TË ORIGJINËS

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar; të nenit 22, të ligjit nr. 24/2023, "Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme"; të nenit 6, të "Rregullores për lëshimin, transferimin, shlyerjen dhe anulimin e garancive të origjinës për energjinë elektrike të prodhuar nga burimet e rinovueshme", miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 300, datë 30.12.2024; si dhe të nenit 15 të "Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s", miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 19.3.2026, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Garancisë së Origjinës , me nr. 863/1 prot., datë 18.3.2026, "Mbi shqyrtimin e kërkesës së shoqërisë 'Ener Trade" sh.p.k. për krijimin e llogarisë në regjistrin elektronik të garancive të origjinës",

konstatoi se:

1. Të dhëna mbi shoqërinë "Ener Trade" sh.p.k.

- Shoqëria "Ener Trade" sh.p.k. është licencuar në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 226 datë 26.10.2018, i ndryshuar dhe veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 227, datë 26.10.2018, i ndryshuar.

2. Korrespondenca dhe dokumentacioni i depozituar nga shoqëria

- Shoqëria "Ener Trade" sh.p.k., me shkresën me nr. 863 prot. datë 10.3.2026, ka paraqitur pranë ERE-s kërkesën për krijimin e llogarisë në regjistrin elektronik të garancive të origjinës, në përputhje me nenin 6, të "Rregullores për lëshimin, transferimin, shlyerjen dhe anulimin e garancive të origjinës", miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 300, datë 30.12.2024.

- Shoqëria ka përcjellë të plotësuar, duke specifikuar të dhënat identifikuese sipas kërkesave të nenit 6, pikës 4.1 të rregullores.

3. Analiza ligjore dhe vlerësimi

- Në përputhje me nenin 22, të ligjit nr. 24/2023, "Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme", ERE është organi kombëtar lëshues i garancive të origjinës dhe mban një regjistër elektronik për qëllime të lëshimit dhe administrimit të këtyre certifikatave.

- Vlerësohet se kërkesa përmbush të gjitha kriteret për hapjen e llogarisë në regjistër si furnizues/tregtar i energjisë elektrike.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Miratimin e kërkesës së shoqërisë "Ener Trade" sh.p.k. për krijimin e llogarisë në regjistrin elektronik të garancive të origjinës.

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Garancisë së Origjinës të njoftojë shoqërinë "Ener Trade" sh.p.k. lidhur me vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes dijeni, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

KËRKESË
Nr. 193/6, datë 1.4.2026

PËR SHPRONËSIM PUBLIK

Agjencia Shtetërore për Shpronësimin shpall kërkesën, "Për shpronësim, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit 'Ndërtimi i Ujësjellësit Çukë–Bërbënesh', Bashkia Sarandë". Subjekti kërkues i këtij projekti është Agjencia Kombëtare e Ujësjellës-Kanalizimeve.

Me anë të këtij publikimi kërkojmë të vëmë në dijeni personat e prekur nga ky shpronësim, për pasurinë, pronë private, sipas vlerësimit paraprak të llogaritur, për pasuritë e llojit "kullotë", bazuar në VKM-në nr. 89, datë 3.2.2016, "Për miratimin e hartës së vlerës së tokës në Republikën e Shqipërisë", sipas tabelës paraprake bashkëlidhur.

Vlera totale paraprake e shpronësimit 283,200 (dyqind e tetëdhjetë e tre mijë e dyqind) lekë.

Personat që preken nga ky projekt, të cilët kanë emrin në tabelën e publikuar, dhe personat të cilët preken, por nuk figurojnë në listë, jo më vonë se 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga publikimi në Fletoren Zyrtare, kanë të drejtë të paraqesin pretendimet e tyre të shoqëruara me dokumentacionin përkatës, si edhe të shprehen nëse janë dakord me të dhënat e publikuara për përfundimin e procedurave të shpronësimit, në Agjencinë Kombëtare të Ujësjellës-Kanalizimeve, si dhe në Agjencinë Shtetërore për Shpronësimin.

DREJTOR I PËRGJITHSHËM
Ermal Shena

LISTA PARAPRAKE E PRONARËVE, PASURITË E PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, TË TË CILËVE PREKEN NGA REALIZIMI I PROJEKTIT "NDËRTIMI I UJËSJELLËSIT ÇUKË–BËRBËNESH", BASHKIA SARANDË

Nr.	Të dhënat e pronësisë			Të dhënat kadastrale (sipas kartelës së pasurisë)						Vlerësimet për shpronësim, sipas llojit të pasurisë				Shënime
										"Kullotë"			Vlera totale	
	Emri	Atësia	Mbiemri	Qyteti	Zona kadastrale	Nr. i pasurisë	Lloji i pasurisë	Sip. totale (m²)	"Kullotë" (m²)	Sipërfaqja (m²)	Çmimi (lekë/m²)	Vlera (lekë)		
1	Refije Artan Alban Elvin	Hamdi Faik Faik Faik	Islamaj Islamaj Islamaj Islamaj	Ksamil	2297	1/785	Kullotë	144,750		1,600	177	283,200	**283,200**	Seksioni D: **1.** Në bazë të urdhrit nr. 1485, datë 19.11.2014, të regjistruesit mbi këtë pasuri, vendoset masa e kufizimit. **2.** Në bazë të vendimit nr. 23-2015-749, datë 14.4.2014, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë, është vendosur marrja e masës së përkohshme të sigurimit të padisë dhe vendosjes së sekuestros konservative mbi këtë pronë. Sigurim padie.
Shuma paraprake													**283,200**	

VENDIM
(i shkurtuar)

Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë me vendimin nr. 41-2025-2063 (487), datë 11.6.2025, vendosi heqjen e zotësisë për të vepruar të shtetasit Aleko Shaban Manoku, i datëlindjes 1.3.1967 dhe vendosjen e tij nën kujdestarinë e motrës së tij, kërkueses Shpresa Manoku.

VENDIM
(i shkurtuar)

Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë me vendimin nr. 41-2025-1754 (424), datë 20.5.2025, vendosi heqjen e zotësisë për të vepruar të shtetasit Orjol Pellumb Myftarago, i datëlindjes 26.2.1989 dhe vendosjen e tij nën kujdestarinë e shtetasit Anesti Guri Spaho (gjini e afërt).

KËRKESË

Shtetasi Shkelzen Tafaj kërkon pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë shpalljen të zhdukur të shtetasit Kujtim Tafaj i datëlindjes 26.4.1958, lindur dhe banues në Malbardhë, Njësia Administrative Milot, Bashkia Kurbin.

KËRKUES
Shkelzen Tafaj

	Formati 61x86/8

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2026

Adresa: Rr. "Nikolla Jorga", Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 176 lekë

Vulosur elektronikisht nga Qendra e Botimeve Zyrtare
Date:2026/04/08 14:12:03 +02'00'
7c87ca7074bd4c65ac045e2dc1db4632

Shënim : Ky dokument është gjeneruar dhe vulosur me anë
të një proçedure automatike nga një sistem elektronik (Qendra e Botimeve Zyrtare)